



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë

E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 482 / 18 Prot.

Tiranë, më 17/09/2019

V E N D I M

Nr. 75, Datë 17 / 09 /2019

P Ë R

AUDITIMIN E USHTRUAR NË 6 SUBJEKTE PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË MAJ-DHJETOR 2018: AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK, DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJENDJES CIVILE, QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT DHE BASHKIA ELBASAN

Nga auditimi i ushtruar në 6 subjektet: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia e Prokurimit Publik, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Qendra Kombëtare e Biznesit, Bashkia Elbasan, mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, bazuar në ISSAI 5300, Manualin e Auditimit TIK si dhe praktikat më të mira, u realizua vlerësimi mbi statusin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të evaduara në maj-dhjetor 2018.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për vlerësimin mbi objektivitetin dhe për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, mendimin nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe nga Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi Verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në maj-dhjetor 2018", të ushtruar në 6 subjekte respektivisht: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia e Prokurimit Publik, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Qendra Kombëtare e Biznesit, Bashkia Elbasan, sipas programit të auditimit nr. 482 prot, datë 30.06.2019, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

1317

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

Nga 6 subjektet e verifikuara rezultoi se Bashkia Elbasan, DAP dhe AKSHI, kanë kthyer përgjigje në KLSH, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, duke hartuar dhe planet e veprimit (*programet e punës*). APP, QKB dhe DPGJC, nuk kanë kthyer përgjigje për hartimin e planit të veprimit për vënien në zbatim të rekomandimeve në respektim të afatit 20 ditë kalendarike, në kundërshtim me pikën 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

QKB dhe AKSHI kanë raportuar në KLSH me shkrim mbi ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”). APP, Bashkia Elbasan, DAP dhe DPGJC nuk kanë kthyer përgjigje edhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi i realizuar në 6 subjektet e verifikuara për zbatimin e *detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimet e kryera të evaduar në maj-dhjetor 2018*, rezultoi një nivel i lartë pranueshmërie në **masën 99%, ku 103 masa organizative** të rekomanduara janë pranuar plotësisht **102 masa** dhe **1 masë organizative** nuk është pranuar. Ndërsa niveli i pranueshmërisë sa i takon propozimeve për përmirësime në legjislacion rezultoi në masën **100%**, ku 3 propozime për përmirësime në legjislacion janë pranuar plotësisht.

Nga një total prej 103 masash organizative të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 26 masa, nuk janë zbatuar 17 masa, janë zbatuar pjesërisht 8 masa, ndërsa 51 masa janë në proces zbatimi. Nga një total prej 3 masash propozime për përmirësime në legjislacion të rekomanduara, nuk janë zbatuar 2 masa dhe 1 masë është në proces zbatimi.

I. AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

KLSH në përfundim të Auditimit, për përmirësimin e gjendjes ka lënë *16 rekomandime si masa organizative*, me shkresën nr. 160/6, datë 03.07.2018 sipas Vendimit nr. 68, datë 30.06.2018 të Kryetarit të KLSH-së, është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 160/1, datë 01.03.2018

AKSHI me marrjen e raportit përfundimtar dhe rekomandimeve ka hartuar dhe planin e veprimit “Për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH”, për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së përcjellë në KLSH brenda afatit ligjor me shkresën nr. 706/20 prot datë 31.07.2018 (AKSHI). AKSHI ka dërguar informacion në KLSH për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 706/21, datë 24.12.2018, duke përfshirë detaje mbi rekomandimet e lëna nga auditimi për një periudhë 6 mujore.

Nga *16 rekomandime si masa organizative*, të cilat janë pranuar plotësisht, është zbatuar plotësisht 1, janë zbatuar pjesërisht 7 masa, janë në proces zbatimi 4 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 4 masa.

KLSH kërkon intensifikimin e veprimeve për përfundimin e rekomandimeve që rezultuan në proces dhe pjesërisht të zbatuara si dhe marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, si vijon:



A. MASA ORGANIZATIVE

1 Gjetje nga auditimi:-AKSHI nuk ka strategji të veçantë zhvillimi, plan-veprimin të strategjisë dhe indikatorët e matjes së performancës së strategjisë të veçantë. Në planin e veprimit e zbatimit të strategjisë 7% të veprimeve i takojnë AKSHI-t pjesa prej 93.% i takon institucioneve të tjera të përfshira në Axhenda Dixhitale të Shqipërisë 2015-2020. Në 120 indikatorët e përcaktuar për matjen e strategjisë, 77 indikatorë (64%) janë klasifikuar si të pa matshëm. Ndryshimet në qeverisje dhe shkrirja e Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike MIAP me VKM Nr. 504. Dt. 13/09/2017 dhe ndryshimi i statusit të AKSHI-t me VKM Nr. 673, Datë 22.11.2017 nuk janë reflektuar në Strategjinë ndër sektoriale 2015-2020, Indikatorët dhe Planin e Veprimit të Strategjisë 2015-2020.

1.1 Rekomandimi:-Strukturat drejtuese të AKSHI, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Brenda vitit 2019

3 Gjetje nga auditimi:-Burimet njerëzore në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2017 kanë rezultuar me mungesa të theksuara, me 30% më pak se struktura plan e miratuar. Situata e burimeve njerëzore për strukturat e shtuara në periudhën Tetor – Dhjetor 2017 paraqitet edhe më e rënduar Grupi i auditimit konstaton se mungesa e burimeve njerëzore në Drejtoria e Vazhdimësisë së Punës BCC, Back-up dhe DRC, Drejtoria e Sigurisë e-Gov, Drejtoria e Infrastrukturës e-Gov, Drejtoria e Sistemeve e-Gov, Drejtoria e Bazave të të Dhënave Shtetërore, Drejtoria e Kërkimit dhe e Zhvillimit, mbart riskun e performancës së dobët të personelit ekzistues si rezultat e mbingarkesës me pasojë mosarritjen e objektivave dhe mosplotësimin e kërkesave për dhënien e shërbimeve.

3.1 Rekomandimi:- Strukturat drejtuese të AKSHI-t të marrin masa për plotësimin e strukturës dhe të kryejnë vlerësimet e herë pas hershme të burimeve njerëzore IT të nevojshme dhe mjaftueshme për arritjen objektivave, si dhe të marrin masa për plotësimin e strukturës IT sipas planit të miratuar.


Menjëherë dhe në vijimësi

4 Gjetje nga auditimi:-Grupi i auditimit duke marrë parasysh ndryshimin e statusit dhe të strukturës së institucionit me VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 si dhe specifikën e Institucionit, ku përdoret një teknologji e niveleve të larta, Vlerëson se shkalla e mbulimit me auditim të brendshëm nga Institucioni nga i cili mbulohet me auditim është i pa specializuar për kryerjen e auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

4.1 Rekomandimi:- AKSHI duke marrë parasysh ndryshimin e statusit dhe të strukturës së institucionit me VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 si dhe specifikën dhe teknologjinë e përdorur të kryej vlerësimin, propozimet e nevojshme për mbulimin me auditim të brendshëm ku të përfshihet dhe auditimi i Teknologjisë së Informacionit.

Brenda vitit 2019

5 Gjetje nga auditimi:AKSHI gjatë vitit 2017 nuk ka zhvilluar analizimin e nevojave të burimeve njerëzore të tij për trajnime si dhe nuk e ka konkluduar këtë analizë (në përputhje me burimet njerëzore dhe financiare) në miratimin e një plani trajnimesh. Zhvillimi i paplanifikuar i trajnimeve ka sjellë mos mbulimin me trajnim të stafit si dhe shpërndarjen sporadike të trajnimeve gjatë vitit, gjë e cila mbart risqet e produktivitetit të ulët, menaxhimit jo efektiv,



rritje të shanseve për mosarritje të objektivave, si dhe mos shfrytëzim në mënyrë efektive të kohës dhe burimeve.

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t të kryejnë analizimin e nevojave për trajnime të burimeve njerëzore në fushën e Teknologjisë së Informacionit në përputhje me burimet njerëzore dhe financiare (të brendshme dhe të jashtme) të hartojnë e zbatojnë trajnimin e tyre sipas një plani të miratuar e dinamik në përputhje me ndryshimet teknologjike të fushës.

Menjëherë dhe në vijimësi

6 Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstaton se ndryshimet strukturore të miratuara të AKSHI-t, nuk janë paraprirë me ndryshime në bazën rregullatore për funksionimin e strukturës së institucionit.

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të AKSHI-t, në të ardhmen të menaxhojnë ndryshimet, duke i paraprirë zbatimit me hartimin e bazave rregullatore për funksionimin e funksionaliteteve të reja të strukturave të institucionit. Në çdo rast procesi duhet të kalojë në procese pilote si dhe nënshtrimin e testeve të nevojshme.

Në vijimësi

7 Gjetje nga auditimi:-Në procedurat e prokurimit për vitin 2017 vërehet mungesa e hartimeve specifike të kriterëve të veçanta. Nuk ka një argument të hollësishëm mbi vendosjen e këtyre kriterëve, duke pasur parasysh edhe rëndësinë, natyrën dhe vëllimin e kontratës.

Në Standardet TIK për vitin 2017, Specifikimet Teknike nuk janë përcaktuar kushtet e veçanta të karakterit teknik (Licenca, Trajnime, Kapacitete, etj), të cilat duhet t'i plotësojë Operatori Ekonomik në kundërshtim me VKM Nr. 703, Datë 29.10.2014 "Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" pika 3.c në të cilën citohet se .."AKSHI ka për detyrë dhe përgjegjësi të përcaktoj standardet e TIK-ut, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, që do të ndiqen nga administrata shtetërore".

7.1 Rekomandimi:- AKSHI në të ardhmen të marrë masa për shmangien e praktikave të tilla me qëllim hartimin e Standardeve TIK, Specifikimet Teknike të rekomandojë kushtet e veçanta të karakterit teknik (Licenca, Trajnime, Kapacitete, etj), të cilat duhet t'i plotësojë Operatori Ekonomik, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, që do të ndiqen nga administrata shtetërore.

Menjëherë dhe në vijimësi


8 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të marrjes në dorëzim të shërbimeve në përputhje me MNSH e lidhura për platformën e-Albania rezulton se grupet e marrjes në dorëzim nuk mbajnë raporte të marrjes në dorëzim të punimeve të kryera nga OE në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Neni 77, Pika 3 mbikëqyrja e kontratës.

Nga auditimi i Amendamentit me Nr. 1876, me objekt shtyrjen me 3 muaj (dt. 14/08/2017) i implementimit të kontratës Nr. Prot. 2571 datë 14.12.2015 për "Shtimi i 209 shërbimeve të reja elektronike për 18 institucione" ka mangësi pasi në të nuk janë paraqitur dhe cilësuar arsyet që kanë pasur palët për shtyrjen e kontratës.

8.1 Rekomandimi: AKSHI në të ardhmen për të shmangur mangësi në praktikat e zbatimit të kontratave duhet të marrë masa që gjatë zbatimit të kontratave të MNSH të lidhura me OE për përfitimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së platformës e-Albania (dhe jo vetëm), duhet të ushtrojë kujdesin e duhur në përputhje me legjislacionin në fuqi për monitorimin e zbatimit të kontratave duke matur, vlerësuar e dokumentuar procesin.

Menjëherë dhe në vijimësi

9 Gjetje nga auditimi:-Nga auditimi rezultoi se mungesat në strukturën e Drejtorisë së Sigurisë e-Gov me 10 punonjës në organike dhe me dy sektorë, me vartësi direkt nga Drejtori i Përgjithshëm përkatësisht në Sektorin e Sigurisë së Informacionit (me 5 punonjës në organike



nga të cilët 2 vende vakante) dhe Sektorin e Infrastrukturës dhe çelësave publikë (me 5 punonjës në organike nga të cilët 2 vende vakante), përbëjnë risk në sigurinë e Gov e me gjerë.

U konstatua se regjistri i risqeve i miratuar për vitin 2017 është në mospërputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10296, Datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 30, Datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Grupi i auditimit konstaton se ai është një proces i nisur, por i pa finalizuar pasi nga 86 risqe të klasifikuara 48 % të tyre nuk është përcaktuar asnjë masë veprimi, nuk janë përcaktuar saktë objektivat dhe nuk janë përfshirë drejtuesit kryesorë në procesin e menaxhimit të riskut

Me konkretisht:

a. Drejtoria e Vazhdueshmërisë së Punës BCC, Backup & DRC

Nuk kanë të identifikuar si risk mungesën e DRC dhe nuk ka masa për minimizimin e këtij risku

Risqet e identifikuar përgjithësisht janë risqe të mbartura nga institucionet e tjera dhe jo risqet e AKSHI-t

Nuk identifikohet si risk mungesat në personel

b. Për Drejtorinë e Bazave të të Dhënave Shtetërore

Nuk ka veprime të përcaktuara për adresimin e boshllëqeve për:

Mungesa e stafit dhe kapaciteteve të duhura në burimeve njerëzore, përbën vonesë në regjistrimin e bazave të të dhënave shtetërore.

Mos bashkëpunimi i institucioneve. Vonesa në regjistrimin e bazave të të dhënave me impakt në ndërveprimin e tyre.

Ndryshimet ligjore të ndodhura ndikojnë në procesin e regjistrimit të bazave të të dhënave shtetërore.

c. Drejtorinë e Portalit Qeveritar e-Albania

Nuk ka veprime të përcaktuara për adresimin e boshllëqeve për:

Vonesat në plotësimin e informacionit nga personat përgjegjës të institucioneve të administratës publike për shtimin e shërbimeve në portalin qeveritar e-Albania.

Mungesë pjesëmarrje e aktorëve përkatës në takime.

Vonesa në dorëzime nga operatori ekonomik.

Mungesa e trajnimeve për përdorimin e backend-it të portalit.

d. Sektori i financës, Burimet njerëzore.

Nuk ka veprime të përcaktuara për minimizimin e riskut të identifikuar për :


Mospërputhja e kërkesave të përcaktuar për pozicionin e punës me rezultatet e konkursit apo intervistës së zhvilluar.

Mungesa e stafit dhe kapaciteteve të duhura në burimeve njerëzore, përbën vonesë në zgjidhjen e problemeve.

9.1 Rekomandimi:- AKSHI të marrë masa me qëllim përmbushjen e misionit të tij duke marrë parasysh dhe funksionalitetet e reja të përcaktuara nga VKM Nr. 673, Datë 22.11.2017, me një proces dinamik dhe gjithë përfshirës të strukturave kryesore të kryej identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, dhe në varësi të burimeve të hartojë masat dhe politikat e nevojshme, reale për minimizimin e tyre.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

10 Gjetje nga auditimi:-Nga auditimi u konstatua se prej vitit 2013, AKSHI ka investuar për zhvillimin e vazhdueshëm të Portalit e-Albania, dhe rritjen e numrit të shërbimeve elektronike të ofruara për qytetarët dhe bizneset, por kryerja e investimeve për krijimin e shërbimeve elektronike dhe ngritjen e protalit, nuk është sinkronizuar në kohë me nxjerrjen e bazës ligjore



për vulën elektronike nga strukturat që kishin të drejtën për të nisur propozimet legislative (VKM nr.495, datë 13.9.2017). Veprimi i cili ka sjellë mos efektivitet në përdorim të portalit për muajt janar – shtator 2017.

10.1 Rekomandimi:- AKSHI në të ardhmen t'i kushtojë një vëmendje të veçantë efektivitetit të përdorimit të fondeve publike duke mbështetur ato në kohë me bazën e duhur rregullatore në përputhje me të drejtat e e reja të përcaktuara në VKM. Nr. 673, Datë 22.11.2017.

Menjëherë dhe në vijimësi

11 Gjetje nga auditimi:-Grupi i auditimit konstaton se suporti ndaj përdoruesve të platformës është i ulët me impakt të drejtpërdrejtë në uljen e numrit të përdorueshmërisë së platformës nga qytetarët, strukturat për auditimin e këtij procesi i cili konsiderohet si një proces tepër sensitiv dhe i domosdoshëm janë të mjaftueshme dhe më konkretisht:

a. Suporti me telefon/chat nuk është funksional dhe koha e kthimit të përgjigjes për suport me formën e aplikimit është relativisht e gjatë, nuk ka ofrimin e shërbimit për përdorues me aftësi të veçanta (probleme shikimi) platforma ofron mundësinë e vendosjes së kontrollit të sigurisë (Captcha) me tinguj zanorë por këto tinguj nuk janë në gjuhën Shqip, gjë e cila sjell vështirësi në përdorim nga qytetarët në mospërputhje edhe me Ligjin nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara". Shkalla e ulët e përdorimit të e-Albania nga grup moshat 35-65 + tregon se këto moshat të nga grup moshat 35-65 + tregon se këto moshat të cilat përbejnë 51.3 % të popullsisë megjithëse kanë nevojë më të mëdha për këto shërbime hasin vështirësi në përdorim të shërbimeve online.

b. Shkalla e ulët e rikthimit të përdoruesve tregon se duhet bërë akoma më shumë punë për analizimin e shkaqeve për të cilat përdoruesit nuk kanë arritur dot të marrin shërbimin e nevojshëm. Mungesa e asistencës në kohë reale bën që grup moshat të cilat kanë nevojë më të madhe për thjeshtëzim në ndërveprim me e-Albania me qëllim të përfitimit të shërbimeve, nuk kanë përdorueshmëri të lartë të platformës për shkak se nuk arrijnë të kryejnë përdorimin e shërbimeve në platformë.

c. Shkalla e ulët e përdorimit të portalit nga përdorues jashtë Shqipërisë për vende me emigracion të lartë të shqiptarve si Italia, Greqia etj nuk janë në listën e përdoruesve më të mëdhenj të sistemit lidhet me faktin e mungesës së asistencës online si dhe shtrirjen e kësaj asistence 24/7 dhe mos marrjen parasysh se shumë nga bashkatdhetarët tanë jetojnë në zona orare të ndryshme nga ajo e Shqipërisë.

Grupi i auditimit konstaton se në platformën e-Albania nuk janë eliminuar plotësisht bug-et dhe ofruar facilitet e nevojshme:

d. Procesi i resetimit të fjalëkalimit nuk është i konsoliduar plotësisht. Është konstatuar se në raste të veprimeve jo të sakta të përdoruesve që kërkojnë të risetojnë fjalëkalimin ka problematika që e pengojnë këtë proces. Duke pasur parasysh se niveli i aftësive ndërvepruese të qytetarëve me platformën e-albania është i llojeve të ndryshme, është tepër e domosdoshme që procesi i resetimit të fjalëkalimit të jetë një proces i konsoliduar dhe pa probleme teknike, pavarësisht veprimeve të sakta ose të pasakta që mund të kryejnë përdoruesit e platformës.

Problematikat që mund të shfaqen në këtë proces kanë impakt të drejtpërdrejtë në uljen e numrit të përdoruesve që kërkojnë të marrin shërbime nga platforma e-albania.

e. Grupi i auditimit konstaton se në shërbimin "Kërkesë për transferim dosje përfitimi (pensioni)" në platformën e-albania kur përdoruesi ka hapur këtë e-shërbim, nuk ka mundësi të bëjë kërkim për shërbime të tjera. Në momentin që përdoruesi klikon butonin "search" pasi shkruan një shërbim tjetër që dëshiron të kërkojë i shfaqet "error" kthimi back të broëser-it, përdoruesit i rishfaqet "error".



f. Disa fusha si 'e-mail, emër, mbiemër, NID duhet të merren automatikisht nga profile i përdoruesit në rastet kur përdoruesi është i loguar në platform. Aktualisht një përdorues mund të vendosi çfarëdo vlere në fushat e kërkuara dhe të dërgojë një kërkesë për suport.

11.1 Rekomandimi:- Drejtoria e platformës e-Albania me qëllim rritjen e përdorimit të platformës të analizojë në mënyrë periodike shkaqet e mos marrjes së shërbimit si dhe të kryejë rivendosjen e suporteve në gjuhën shqipe me telefon/chat me mbulim 24/7. Në ofrimin e suportit të kihet parasysh kuadri ligjor në lidhje me kërkesat e kategorive me aftësi të veçanta.

Menjëherë dhe në vijimësi

12 Gjetje nga auditimi:-Grupi i auditimit konstaton se loget e përgjigjeve të kërkesave dhe ankesave fshihen automatikisht 30 ditë pasi ka ndodhur veprimi. Nuk ka gjurmë të analizimit të procesit të ndihmës dhe suportit për përdoruesit e e-Albania në kundërshtim me Rregulloren e Sigurisë së AKSHI-t miratuar me Nr.Prot. 2420 dt. 29/08/2016; Kreu VI Administrimi i Sistemeve të Informacionit, Neni 21 Mbajtja e Logeve i cili përcakton: “Do të mbahen dhe do të ruhen loget (shënimet e shkurtuara) për të gjithë aksesimet në sistemet e AKSHI-t, për të gjithë përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe me Ligjin Nr. 10 273, datë 29.4.2010 Neni 18 “Ruajtja e dokumentit elektronik”.

12.1 Rekomandimi:- AKSHI të marri masa për analizimin e konfigurimeve dhe kapaciteteve ekzistuese ruajtjes së logeve, dhe të hartojë dhe miratojë në përputhje me legjislacionin e “ruajtjes së dokumentit elektronik”, kohën e ruajtjes, procedurat e analizimit dhe fshirjes së logeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13 Gjetje nga auditimi:-Grupi i auditimit konstaton se Platforma E-Albania, publikon informacione dhe shërbime nga burime të cilat kanë data baza të pa certifikuara (nga AKSHI) duke mos siguruar ndërveprimin e duhur për ruajtjen e të dhënave personale. Grupi i auditimit konstaton se politikat e privatësisë janë thyer dhe të dhënat personale janë të ekspozuara, me konkretisht:

1. Gjenerimi i faturës të UKT-së në platformën e-Albania pa bërë lidhjen me numrin NID me ‘KODI I KLIENTIT’, mundëson leximin e informacioneve të faturimeve që nuk i përkasin personit të loguar në platformë.
2. Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se Regjistri i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor është bazë të dhënash e regjistruar, si rezultat i problematikave në ndërveprimin e kësaj baze të dhënash me regjistrin e gjendjes civile (identifikimi i mbështetur në NID) identifikimi i përdoruesit që kërkon shërbimin jo gjithmonë është i saktë.

13.1 Rekomandimi:- AKSHI me grupe të përbashkëta me institucionet që ofrojnë shërbime në platformën e-Albania të marrë masa për analizimin e bazave të të dhënave të platformës dhe të kryejë ndërhyrjet e nevojshme për plotësimin e kriterëve të domosdoshme për ndërveprim duke respektuar përcaktimet e Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 (ndryshuar) “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Për shërbimet apo elementë të tyre të cilat nuk plotësojnë kriteret e nevojshme ligjore të merren masa e pezullimit të shërbimit deri sa të sigurohet plotësimet e nevojshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

14 Gjetje nga auditimi:-AKSHI nuk po zhvillon teknologji të cilat do ti përgjigjen fluksit në rritje të të dhënave (big data) mbështetur në të ashtuquajturin “programim logjik” i cili mbështetet në logjikën e vetë zhvilluesve të softuerëve për përzgjedhjen, grupimin e ndërlidhjen e informacioneve.

Grupi i auditimit konstaton se AKSHI nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të:

- a. Reduktuar pasigurinë që ka të bëjë me përpunimin dhe përdorimin e të dhënave masive (Big Data), dhe ofrimi i një platformë të plotë dhe efektive të dhënash për vendimmarrësit.
- b. Ulur marzhin e gabimeve në analizën e të dhënave masive (Big Data) duke udhëzuar përdoruesit për rrugën e duhur janë të pa mjaftueshme.
- c. Përdorimin e Big Data-t për të ndihmuar vendimmarrësit të marrin vendimet e duhura bazuar në të dhëna dhe analiza të menaxhimit të cilësisë (Managing Total Quality/MTQ).

Grupi i auditimit konstaton se funksionalitetet e gjenerimit të statistikave në Drejtorinë Juridike nuk përbën oportunitet për zhvillimin e statistikave në përgjithësi dhe data analytics në veçanti.

14.1 Rekomandimi: -AKSHI të marrë masa në zbatim të praktikave me të mira të fushës analizimin e situatës me objektiv ndryshimet e nevojshme strukturore dhe planifikimin e burimeve të nevojshme për përdorimin e statistikave dhe big data me prioritet zhvillimin e Teknologjive të cilat do ti përgjigjen fluksit në rritje të të dhënave (big data) mbështetur në programe logjike.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

15 Gjetje nga auditimi: -Grupi i auditimit konstaton se AKSHI nuk ka Disaster Recovery Plan (DRP) dhe Disaster Recovery Center (DRC), mungesa e të cilave mbart riskun e humbjes së të dhënave të cilat ruhen dhe përpunohen në Data Center e AKSHI-t me një impakt të madh, të një rëndësie mbarë kombëtare.

15.1 Rekomandimi:- AKSHI duke marrë parasysh edhe shtimin e funksionaliteteve të marri masat e nevojshme për hartimin e një Disaster Recovery Plan (DRP) si dhe duke kryer vlerësimin e impaktit mbarë kombëtar të humbjes së informacionit nga mungesa e DRC të paraqesë projekte konkrete pranë instancave përkatëse për financimin e një Disaster Recovery Center (DRC).

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi


16 Gjetje nga auditimi:-Grupi i auditimit konstaton se portali e Albania nga data e krijimit 28 nëntor 2012 deri me datë 21.09.2017 ka funksionuar pa një rregullore të miratuar. Kjo rregullore nuk ka politika në hapjen dhe mbylljen e userave, për punonjësit e Administratës Publike dhe Institucioneve Publike dhe Jo publike, të cilët kanë akses në shërbimet e e-Albania. Gjithashtu në sistem ndodhen usera të pa identifikuar me emër, mbiemër me impakt në përdorimin e pakontrolluar të të dhënave personale të mbrojtura me ligj. Procesi i dërgimit të emailit nuk kërkon verifikimin e vërtetësisë së adresës së e-maileve si dhe nuk ka info shtesë për vendndodhjen e dërguesit të këtij emaili që kërkon suport ose ndihmë si dhe mosha e tij.

16.1 Rekomandimi: Me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale AKSHI të marrë masa për ndërhyrjet e nevojshme në rregulloren e portalit për plotësimin e politikave në hapjen dhe mbylljen e userave, për punonjësit e Administratës Publike dhe Institucioneve Publike dhe Jo publike, të cilët kanë akses në shërbimet e e-Albania.

Menjëherë dhe në vijimësi

II. AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK, TIRANË - APP

KLSH në përfundim të Auditimit, për përmirësimin e gjendjes ka lënë 18 rekomandime si masa organizative dhe 2 propozime apo përmirësime në legjislacion, me shkresën nr. 865/8 datë 17.12.2018 sipas Vendimit nr.198, datë 17.12.2018 të Kryetarit të KLSH-së, ka dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 865/2, datë 11.09.2018.



APP nuk ka kthyer përgjigje mbi hartimin e planit të veprimit për vënien në zbatim të rekomandimeve në respektim të afatit 20 ditë kalendarike, në kundërshtim me pikën 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. APP nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga 18 rekomandime si masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar plotësisht 6 dhe janë në proces zbatimi 12 masa organizative. Nga propozimet apo përmirësimet në legjislacionit 2 masa të rekomanduara janë pa zbatuar.

KLSH kërkon intensifikimin e veprimeve për përfundimin e rekomandimeve që rezultuan në proces si dhe marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, si vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACION

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi përmbajtjen e Buletinit që publikon APP bazuar në VKM nr. 176 datë 29.03.2006 rezulton se janë pjesë e tij dhe njoftimeve si Vende të Lira Pune, Shkollat e Larta dhe nga DAP, të cilat nuk janë në përputhje me objektin e aktivitetit të saj përcaktuar në ligjin 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ndërkohë që në VKM janë lënë jashtë publikimit njoftime që lidhen me Konkensionet/PPP.

Së pari publikimi i njoftimeve në kategoritë përmendur më sipër nuk orienton drejt të interesuarit dhe së dyti data e dorëzimit mund të ketë përfunduar përpara se të publikohet njoftimi pasi afati i publikimit të Buletinit është çdo 5 ditë.

1.1. Rekomandimi: KM dhe APP të konsiderojnë ndryshime në VKM nr. 176 datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve” duke garantuar që përmbajtja e Buletinit të jetë në përputhje me objektin e aktivitetit përcaktuar në Ligj dhe publikimet e kategorive që nuk janë në përputhje me objektin e APP të delegohen në institucione përgjegjëse

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

2. Titulli i gjetjes Me ndryshimet e strukturave TI, APP-së i cënohet pjesa e rëndësishme e Qeverisjes TI. Roli i strukturës TI nuk duhet dhe mund të zëvendësohet me struktura të tjera pasi struktura TI luan një rol të rëndësishëm në drejtim të mbledhjes së kërkesave, analizimit të nevojave, dhënies së zgjidhjeve dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje për problemet e TI.

2.1 Rekomandim për përmirësim Ligjor: Kërkimit KM ndryshimin e VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 pika 23.

Ishte:Strukturat përgjegjëse së AKSHI-t, Punonjësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK) në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave , kalojnë tek AKSHI, brenda datës 31.12.2017 dhe do të trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil në rastin e mbylljes së ristrukturimit të institucionit , apo Kodit të Punës AKSHI vendos në dispozicion të institucioneve të përmendura në shkronjën “i” të pikës 6 personelin e mjaftueshëm dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për të mbajtur në funksion optimal sistemet të cilat nuk preken nga fushat e veprimit të këtij vendimi (kalimi i strukturave TI në varësi nga AKSHI-t).

Shtohet:Në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, ngelet/krijohen strukturave TI në varësi direkt nga menaxhimi i lartë i institucioneve përkatëse me funksion kryerjen e detyrave të qeverisjes TI.

Brenda vitit 2019

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se APP nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit.

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të APP, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditivi: App nuk ka menaxhuar ndryshimin e strukturave të burimeve njerëzore të strukturave TI.

2.1 Rekomandimi: APP në të ardhmen të marrë masa për rishikimin e bazës rregullative të strukturave TI në APP në përputhje me çdo ndryshim strukturor të kryer.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Sistemi i prokurimit publik nuk ka filtrat e nevojshëm për mos lejimin e hedhjes të të dhënave gabim, apo lejuar lidhjen e kontratave pa pasur fondin limit të nevojshëm në 14 raste fondi i prokuruar (609,887,131 lekë) është më i madh se fondi limit (395,611,677 lekë) në vlerën -214,275,454 lekë.

5.1 Rekomandimi: APP të marri masat e nevojshme për vendosjen në bazën e të dhënave të sistemit të prokurimit publik të filtrave të nevojshëm si dhe kontrolleve në input e të dhënave.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi:

6.1 Procedurat e Prokurimit të shpallura kanë një shkallë të lartë prej 19% të anulimit (vlerës së fondit), duke treguar se puna e AK për përgatitjen e procedurave (përcaktimi i nevojave, studimi i tregut, hartimi i dokumentacionit në përputhje me legjislacionin) është e pa mjaftueshme dhe ka nevojë për përmirësim. Mos kryerja në kohë e investimeve duhet të konsiderohet jo vetëm si mos efektivitet në përdorimin e burimeve por impakti negativ i tyre ka një spektër me të gjërë.

6.2 Nga analiza e procedurave të publikuara dhe të kryera me përfundim lidhje kontrate rezultojnë me risk 393 procedura me fond të prokuruar 8,767,669,428 lekë të cilat janë lidhur në muajt janar-shkurt si rrjedhojë e kohës së limituar në përgatitjen e dokumentacionit përkatës si dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Paraqesin risk të lartë në lidhje me kohën e nevojshme për zbatimin e kontratave 435 procedura me fond 8,248,475,384 të cilat janë lidhur në muajin dhjetor 2017.


6.1 Rekomandimi: APP të kryejë monitorimin dhe vlerësimin e situatës dhe të ndërmarrë përmirësimet e nevojshme në aktet rregullatore të procedurave të prokurimit për minimizimin e fenomeneve të cilat ulin performancën e prokurimit publik.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se:

a. Përshkrimet e punës ku janë transferuar specialistët TI, nuk kanë ndryshuar shumë nga detyrat e mëparshme që po të njëjtët specialist kryenin.



10

- b. Në asnjë përshkrim pune nuk janë pasqyruar përgjegjësitë që lidhen me sigurinë rregullorja e sigurisë paragrafi 5.1 “Rregullorja për organizimin e punës në APP”.
- c. Nuk rezultojnë të dokumentuara detyrat e përkohshme që kryejnë deri në plotësimin e strukturës me specialist TI nga AKSHI.
- d. Detyra të përcaktuara në rregulloren e sigurisë si prsh “**Administrator**” nuk adresohen në përputhje me përshkrimin e punës së punonjësve.
- e. Specialistët e TIK jo vetëm që nuk kanë kryer trajnime për periudhën object auditimi, por APP nuk ka marrë as përgjigje për ndonjë pjesëmarrje në të ardhmen nga insitucionet të cilave ju është drejtuar AKSHI-t dhe AKSK.

7.1 Rekomandimi: APP të rishikojë përshkrimin e punës për çdo punonjës, për të përcaktuar sa më afër detyrave reale që specialistët e saj kryejnë ku të përcaktojë dhe detyrat funksionale që dhe të identifikojë detyrat e përkohshme, të cilat kryhen aktualisht nga specialistët e saj por që do të transferohen tek AKSHI në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se numri prej 4 specialistësh në teknologjinë e informacionit për vitin 2017 ka qenë shumë i vogël, për ofrimin e asistencës teknike për probleme të ndryshme që mund të hasin autoritetet kontraktore si dhe garantimin e disponibilitetit të sistemit të prokurimit që është 24 orë në 7 ditë të javës.

9.1. Rekomandimi: APP të identifikojë të gjitha detyrat lidhur me asistencën teknike që janë realizuar nga specialistët e saj, që të parashikojë saktë delegimin e tyre tek specialistët e TIK që do të vihen në dispozicion nëpërmjet AKSHI-t.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi: Nisur nga eksperiencia e grupit të auditimit si dhe gabimit të konstatuar në procedurën e mësipërme “Blerje pajisje kompjuterike, UPS dhe fotokopje 2017”, për arsye të ndryshme, ka mjaft raste ku ana shkruese nuk përputhet me atë elektronike. Gjithashtu mbajtja e dokumentave shkresor, pa i bërë pjesë të dosjes elektronike të procedurave të prokurimit, rrit riskun e tjetërsimit të tyre me kalimin e kohës. Grupi i auditimit vlerëson se është e nevojshme përditësimi i faqes së APP, duke krijuar mundësinë e hedhjes apo ngarkimit të të gjithë dokumentacionit të procedurave të prokurimit, duke rritur besueshmërinë e gjurmës së auditimit të këtyre procedurave.

11.1. Rekomandimi: APP të shqyrtojë mundësinë e shtimit të opsionit të hedhjes së të gjithë dokumentacionit të tenderit me qëllim rritjen e besueshmërisë në procedurat e prokurimit duke e plotësuar elektronikisht të gjithë gjurmën e auditimit.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi risqet në TIK, rezultoi se:

-Risqet e identifikuar për vitin 2017 si dhe prioriteti dhe probabiliteti janë të njëjta me 3 risqet e identifikuar në vitin 2018, në mospërputhje me nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Në të dy regjistrat e viteve 2017 dhe 2018 nuk rezulton që gjatë vitit të ketë patur përditësime me risqe të reja të identifikuar gjatë periudhës.

-Nuk janë analizuar dhe dokumentuar si pjesë e regjistrat të riskut hapat që duhen ndërmarrë nga specialistët e TIK, për minimizimin e çdo risku të identifikuar për teknologjinë e informacionit.



- Nuk janë identifikuar risqe në lidhje me: *sigurinë, disponibilitetin dhe integritetin e sistemit dhe të dhënave që gjenerohen nëpërmjet sistemit të prokurimit publik* si dhe palët e treta që janë kontraktuar për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit të prokurimit elektronik dhe fizik.

-Nuk janë identifikuar risqe të mundshme që lidhen me plotësimin e saktë të të dhënave për procedurat e parashikuara nga autoritet kontraktore, për tu zhvilluar në vitin kalendarik, proces ky i cili është informatizuar dhe ka përfunduar fazën e testimit.

-Nuk janë identifikuar risqet në burimet njerëzore të TIK, të cilat duhen adresuar për të siguruar mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e procesit të prokurimit.

-Ndarja ose transferimi i risqeve së bashku me asetet tek AKSHI, dhe për cilat risqe ndjekja dhe minimizimi i tyre do të administrohen nga APP.

-Nuk janë analizuar dhe identifikuar mbivendosjet ligjore, si dhe hapat që do të ndërmerren për minimizimin e problemeve që mund të ndodhin në sistemin e prokurimit si dhe përgjegjësitë ndërmjet e AKSHI-t dhe APP.

-Nuk janë identifikuar rrisqe që lidhen me hapa të procedurës së prokurimit që janë ende të painformatizuar për përmirësim të sistemit të prokurimit si prsh, të dhënat që lidhen me nënkontraktimin të cilin autoritet kontraktore aktualisht e administrojnë në letër.

12.1. Rekomandimi: APP me transferimin e aseteve dhe burimeve njerëzore te AKSHI, në bashkëpunim me këtë të fundit të analizojë dhe të konsiderojë risqet që lidhen me Teknologjinë duke bërë një ndarje sa më reale midis atyre që do të administroje vetë dhe atyre që për shkaqe teknike i delegohen AKSHI-t. Te dokumentohen përgjegjësit dhe hapat që duhen ndjekur për çdo risk të identifikuar. APP të përditësojë regjistrin me risqe të reja të identifikuara gjatë periudhës dhe të mbajë në monitorim të vazhdueshëm ecurinë e risqeve, ku theksi duhet të jetë në garantimin e sigurisë, disponibilitetit dhe integritetit të sistemit dhe të dhënave që gjenerohen nga sistemi i prokurimit publik.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Portali i APP nuk përdor një lidhje të sigurtë (*connection security*) HTTPS (*HyperText Transfer Protocol Secure*) (*Not secure status*) që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm. Në mungesë të kësaj certifikate ekziston risku për humbjen e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali.

14.1. Rekomandimi: APP në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e faqes Web, të marrin masa për përmirësimin e faqes Web me elementët përkatës të sigurisë (*certifikatën e sigurisë*) së navigimit online për të rritur sigurinë dhe ndihmesën ndaj përdoruesve.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: APP disponon politika të shkruara mbi vazhdimësinë e punës (*business continuity*), si dhe politika të shkruara mbi rimëkëmbjet nga katastrofat (*disaster recovery*). Nga auditimi u konstatua se APP nuk disponon dokumentacion për ngritjen e grupit të punës apo të testimeve zhvilluara për funksionimin e këtyre dy politikave mjaft të rëndësishme për sistemin e APP, në kundërshtim me pikën 9.1 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017. Këto testime duhet të kryhen në mënyrë periodike dhe me theks të lartë sa herë të ketë ndryshime thelbësore, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme se sistemi do të funksionojë në të gjitha situatat hipotetike, dhe se burimet njerëzore janë të mirënjohura me zbatimin e hapave që duhen ndjekur. Për këtë arsye grupi i auditimit shprehet me rezervë mbi funksionimin apo jo të dy politikave të mësipërme mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjen nga katastrofat, në rast se do të jetë e nevojshme.

Gjithashtu plani i fundit i rekuperimit nga katastrofa i vënë në dispozicion të grupit të auditimit është me datë 07.04.2017, në kundërshtim me pikën nr. 9.3 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017, sipas së cilës këto plane duhet të rishikohen të paktën një herë në vit.

15.1. Rekomandimi: Nga APP të merren masat e nevojshme për testimin e politikave mbi vazhdimësinë e punës (business continuity) dhe mbi rimëkëmbjen nga katastrofat (disaster recovery) sa herë që ato azhurnohen apo ndryshojnë, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme se do të funksionojë në të gjitha situatat hipotetike, dhe se burimet njerëzore janë të mirënjohura me zbatimin e hapave që duhen ndjekur. Nga APP të merren masat e nevojshme për përditësimin e planeve të rimëkëmbjes nga katastrofat dhe vazhdimësisë së punës të paktën një herë në vit me qëllim të qënurit gjithnjë në koherent me ndryshimet e ndodhura, në përputhje me Planin e Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit e testoi faqen e APP në disa “free page security test”, nga ku rezultuan mjaft raste ku shfaqeshin “malware” si dhe pika të dobëta dhe jo të sigurta të faqes. Për arsye sigurie dhe konfidencialiteti, grupi i auditimit nuk do ti bëjë pjesë të materialit, por do ti komunikojë ato me stafin përgjegjës të APP.

16.1. Rekomandimi: APP të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për analizimin e rasteve të konstatuara nga grupi i auditimit, si dhe verifikimin periodik dhe të shpeshtë të sigurisë së faqes Web, me qëllim minimizimin e kërcënimeve dhe rritjen e sigurisë së faqes Web.

Brenda 2019 dhe në vijimësi

18.Gjetje nga auditimi: Agjencia e Prokurimit Publik ka lejuar Autoritetet Kontraktore nëpërmjet një llogarie administratori të hapë llogari të tjera sipas nevojave të institucionit për të aksesuar në sistemin e APP. Nga auditimi u konstatua se hapja e këtyre përdoruesve mbetet pothuajse e pamonitoruar, pasi vetë APP nuk kryen monitorime që lidhen me këtë veprim, duke rritur riskun e krijimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e tyre.

18.1. Rekomandimi: Në vazhdimësi APP të marrë masa për verifikimin e përdoruesve të hapur nga llogaritë administrative të Autoriteteve Kontraktore, duke ulur riskun e humbjes së konfidencialitetit të të dhënave si dhe keqpërdorimit të tyre.

Brenda 2019 dhe në vijimësi

III. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE - DAP

KLSH në përfundim të Auditimit, për përmirësimin e gjendjes ka lënë 10 rekomandime si masa organizative, me shkresën nr. 551/7, datë 17.09.2018 sipas Vendimit nr. 133, datë 17.09.2018 të Kryetarit të KLSH-së, ka dërguar Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 551/1, datë 12.06.2018.

DAP ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 6671/1, datë 26/09/2018 mbi hartimin e planit të veprimit nr. 99, datë 26/09/2018 për vënien në zbatim të rekomandimeve në respektim të afatit 20 ditë kalendarike, në zbatim të pikës 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga ana e institucionit nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.



Nga 10 rekomandime, si masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 9 masa dhe nuk është pranuar 1 masë; është zbatuar plotësisht 1 masë, janë në proces zbatimi 7 masa organizative, ndërkohë që 1 masë organizative nuk është zbatuar.

KLSH kërkon intensifikimin e veprimeve, për përfundimin e rekomandimeve që rezultuan në proces si dhe marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2017 për përdoruesit e sistemit janë kryer rreth 2 herë më shumë trajnime se ato të zhvilluara gjatë vitit 2016, trendi në rritje vazhdon edhe për trajnimet e kryera gjatë vitit 2018. Ndryshimet e strukturës së TI-së përgjatë vitit 2017 e në vazhdim, mbështetur në Urdhrit e KM nr. 178, datë. 10.10.2017 dhe VKM nr. 673, datë. 22.11.2017 mbartin riskun e mos kryerjes së funksionaliteteve të kësaj strukturë TI si rezultat i frekuencës së shpeshtë të ndryshimeve me impakt e mos përmbushjen e objektivave dhe plotësimit të misionit të DAP. Qenia e strukturave TI të përqendruara për vitin 2018 e në vijim (tek AKSHI) zgjidh problemet e mungesës në staf TI të vërejtura në DAP gjatë vitit 2017, por mbart risqet që vinë nga menaxhimi të tyre nga dy struktura (DAP dhe AKSHI).

1.1 Rekomandimi: DAP në cilësinë e autoritetit përfitues së shërbimeve të mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit nga AKSHI-n të marrë masa institucionale dhe ndërinstitutionale për menaxhimin e ndryshimeve të burimeve njerëzore të lidhura me teknologjinë e informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja e infrastrukturës TIK në DAP nuk garanton funksionimin normal të sistemeve, ajo është e vjetruar dhe amortizuar, investimet e kryera në këtë fushë janë të pa pamjaftueshme, përpjekjet për identifikimin e nevojave duke bashkëpunuar edhe me institucione të specializuara të fushës (AKSHI) rezultojnë se nuk kanë arritur të zgjidhin problemet e financimit për garantimin e vazhdimësisë së punës.


2.1Rekomandimi: DAP me qëllim përthithjen e investimeve nga buxheti i shtetit dhe nga donatorët në bashkëpunim me AKSHI-n të marri masa për kryerjen e vlerësimit të nevojave për investime në sistemet e informacionit që mbështesin veprimtarinë e institucionit, si dhe të hartojnë projekte për ngritjen e një infrastrukture TIK që siguron Vazhdueshmërinë e Biznesit dhe Rimëkëmbjen nga Katastrofat.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimi konstaton se përdoruesit e HRMIS të cilët janë të lidhur në “mënyrë të sigurt” me aplikacionin nëpërmjet Web VPN nuk arrijnë të shikojnë raportet që gjeneron sistemi, me pasojë mos shfrytëzimin e këtyre raporteve në menaxhimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të burimeve njerëzore në plotësimin e misioneve dhe arritjen e objektivave të institucioneve përkatëse.

3.1 Rekomandimi: DAP me qëllim përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të burimeve njerëzore nga institucionet që përdorin sistemin HRMIS në funksion të plotësimit të misioneve dhe arritjes së objektivave përkatëse të marri masa për sigurimin jo vetëm të lidhjeve të sigurta por edhe ofrimin e mundësive për shfrytëzimin e raporteve që gjenerohen nga ky sistem.

Menjëherë dhe në vijimësi



4. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e përdoruesve aktiv dhe të bllokuar në sistem për vitin 2017, konstaton se drejtuesit e institucioneve nuk informojnë ose informojnë me vonë mbi largimin nga detyra të burimeve njerëzore përdorues të HRMIS. Për vitin 2017, nga 302 përdorues të hapur në sistemin HRMIS, ndodhen në statusin të bllokuar 34 përdorues, mos mbyllja e tyre përbën cenim të sigurisë së sistemit dhe është në kundërshtim me Vendimin Nr. 117, datë 05.03.2014, “Mbi praktikat që duhet të ndjekin institucionet për informimin e DAP-it mbi largimin e përdoruesve të HRMIS”.

4.1 Rekomandimi: DAP në cilësinë e autoritetit i cili menaxhon sistemin HRMIS në bashkëpunim me institucionet përdoruese të sistemit të marri masa për evidentimin dhe vënien para përgjegjësisë të çdo rasti të thyerjes së përcaktimeve të Vendimit Nr. 117, datë 05.03.2014, “Mbi praktikat që duhet të ndjekin institucionet për informimin e DAP-it mbi largimin e përdoruesve të HRMIS”.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Përdoruesit e sistemi HRMIS përgjegjës për hedhjen e të dhënave janë punonjës në strukturat e burimeve njerëzore dhe të financës të Institucioneve përkatëse. Nga analizimi i bazës së të dhënave të sistemit HRMIS rezulton se ky sistem për vitin 2017 ka patur mesatarisht 643 përdorues. Nga analiza në vite e përdoruesve të sistemit rezulton një trend rritës i numrit të përdoruesve. Grupi i auditimi konstaton se ky sistem aksesohet nga përdoruesit e institucioneve me një frekuencë të çrregullt dhe përdoruesit e tij përqendrojnë punën vetëm në muajt e fundit të vitit, duke rënduar sistemin në këtë periudhë me pasojë mos pasqyrimin në sistem të gjendjes reale të burimeve njerëzore.

5.1 Rekomandimi: DAP në cilësinë e autoritetit i cili menaxhon sistemin HRMIS në bashkëpunim me institucionet përdoruese të sistemit të marri masa për evidentimin dhe vënien para përgjegjësisë të rasteve të mos plotësimit ritmik dhe në kohë reale të sistemit me informacion.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Nga analizimi i bazës së të dhënave të sistemit HRMIS mbi shkallën e plotësimit të dosjeve të punonjësve për Institucionet Vendore për vitin 2017 rezulton se Institucionet Vendore paraqiten me një shkallë të ulët të përdorimit të sistemit HRMIS.

Grupi i auditimi konstaton se shkaqet e këtij mospërdorimi janë:

- Mos qenia e sistemeve të pushtetit lokal në gov.net.
- Shkalla e ulët e informatizimit në këto institucione.
- Përdorimi në disa raste i programeve të tjerë për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Më hollësisht situata në Institucionet e Qeverisjes Vendore paraqiten:

- 24 Institucione rezultojnë me mospërdorim total të sistemit HRMIS
- 21 Institucionet rezultojnë me përdorim më të ulët se mesatarja e përdorimit nga Institucionet e Qeverisjes Vendore të sistemin HRMIS

6.1 Rekomandimi: DAP në cilësinë e autoritetit administrues për sistemin HRMIS në bashkëpunim me AKSHI-n dhe institucionet vendore përdoruese të sistemit të marri masa për:

- Kapërcimin e pengesave të rrjedhura nga mos qenia e sistemeve të pushtetit lokal në gov.net.
- Analizimin e situatës dhe nxitja e investimeve për informatizimit në këto institucione.
- Rishikimin e kuadrit ligjor për mos lejimin e investimeve në programe të tjerë për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi



7.1 Gjetje nga Auditimi: Nga analizimi i bazës së të dhënave të sistemit HRMIS mbi shkallën e plotësimit të dosjeve të punonjësve për Institucionet e Pavarura rezulton se gjatë vitit 2017 ka një përmirësim të ndjeshëm për plotësimin e dosjeve krahasuar me një vit më parë. Nga analizimi i bazës së të dhënave për këto institucione rezulton se ka një përdorim mesatar prej 73% të sistemit HRMIS, por 2 Institucione rezultojnë me mospërdorim total të sistemit HRMIS

7.2 Gjetje nga Auditimi: Nga analizimi i bazës së të dhënave të sistemit HRMIS mbi shkallën e plotësimit të dosjeve të punonjësve për Institucionet e Administratës Qendrore rezulton se gjatë vitit 2017 ka një përmirësim të ndjeshëm nga këto institucione, për plotësimin e dosjeve, krahasuar me një vit më parë. Situata për 6 mujorin e parë të viti 2018 paraqitet pa ndryshime në krahasim me një vit më parë. Këto institucione përbejnë 755 përdorues me një shkallë mesatare përdorimi në Sistemit HRMIS prej 60 %.

Grupi i auditimit konstaton se me gjithë arritjet, vërehen diferenca të theksuara të grupuara si vijon:

- 271 Institucione të Administratës Qendrore rezultojnë me shkallë përdorimi 0%.
- 13 Institucione të Administratës Qendrore rezultojnë me shkallë përdorimi nga 1% -8%.
- 37 Institucione të Administratës Qendrore rezultojnë me shkallë përdorimi nga 11% - 59%, që është nën mesataren e përdorimit nga Institucionet e Administratës Qendrore
- 434 Institucione të Administratës Qendrore rezultojnë me shkallë përdorimi nga 60% - 100%.

7.3 Rekomandimi: DAP në cilësinë e autoritetit i cili menaxhon sistemin HRMIS në bashkëpunim me institucionet përdoruese të sistemit të marri masa për evidentimin e shkaqeve specifike, të cilat pengojnë zgjerimin e përdorimit të sistemit si dhe bashkëveprojnë veprimet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe AKSHI-n për ndërprerjen e investimeve paralele që këto institucione kryejnë për ngritjen dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve të menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Nga analiza e bazës së të dhënave të sistemit HRMIS u konstatua mospërputhje në datën për rastet e ristrukturimit të një institucioni ekzistues. Mos respektimi i afateve ligjore të hedhjes së strukturës nga autoriteti përgjegjës i miratimit të strukturës sjell impakt financiar në rekordet e lidhjes dhe shkëputjes së marrëdhënieve financiare të punonjësve.

9.1 Rekomandimi: DAP në cilësinë e autoritetit i cili menaxhon sistemin HRMIS në bashkëpunim me AKSHI-n, për rritjen e efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit të burimeve njerëzore dhe plotësimin e misioneve dhe arritjen e objektivave të institucioneve të marri masa për kryerjen e investimeve në sisteme inteligjente për analizimin e bazës së të dhënave për monitorimin e aktivitetit të përdoruesve.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

IV. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJENDJES CIVILE - DPGJC

KLSH në përfundim të Auditimit, për përmirësimin e gjendjes ka lënë 20 rekomandime si masa organizative, me shkresën nr.152/6, datë 08.07.2018 sipas Vendimit nr.67, datë 30.06.2018 të Kryetarit të KLSH-së, është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 152/1, datë 02.03.2018.

 16 1332

DPGJC nuk ka kthyer përgjigje mbi hartimin e planit të veprimit për vënien në zbatim të rekomandimeve në respektim të afatit 20 ditë kalendarike, në zbatim të pikës 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga ana e institucionit nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse në auditimin e mëparshëm, për përmirësimin e gjendjes janë lënë 20 rekomandime si masa organizative, të cilat janë pranuar, nga të pranuarat janë zbatuar 6 masa dhe janë në proces zbatimi 6 masa organizative, ndërkohë që 8 masa organizative nuk janë zbatuar.

KLSH kërkon intensifikimin e veprimeve, për përfundimin e rekomandimeve që rezultuan në proces si dhe marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i kuadrit rregullator të funksionimit të sistemeve teknologjike u konstatua se DPGJC:

- Nuk ka Rregullore të Teknologjisë së Informacionit ku të mbështesë aktivitetin e saj;
- Nuk disponon rregullore/udhëzime operacionale që përcakton detyra periodike apo të vazhdueshme, hapat që duhet të ndiqen, si dhe personat përgjegjës lidhur me veprimet, që përdorues të ndryshëm kryejnë në sistem, sipas pozicionit të punës dhe të drejtave të çdo punonjësi/përdoruesi;
- Nuk disponon procedura kontrolli apo rregullore, për menaxhimin dhe zhvillimin e ndryshimeve që implementohen në sistem me përfshirjen e autorizimit nga menaxhimi; rezultatet e testeve, autorizim nga menaxhimi përpara kalimit të ndryshimeve në mjedisin live, rishikimi i menaxhimit të efekteve të çdo ndryshimi, mirëmbajtje e regjistrimeve të përshtatshme; procedura e kthimit në një hap më përpara (rollback) në rast se diçka nuk shkon mirë si dhe procedurat për kryerjen e ndryshimeve emergjente. Shqyrtimi dhe marrja e masave lidhur me incidentet është bërë rast pas rasti nga specialistët IT.
- Nuk disponon analizë të dokumentuar mbi performancën e sistemit në kohë reale apo periodike në funksion të përmirësimeve të tij.
- Nuk ka të dokumentuar një procedurë, për përfshirjen e kërkesave të përdoruesve në kërkesat e MNSH.
- Mungojnë trajnimet për rritjen profesionale të një stafi të brendshëm të kualifikuar specialistë TI, me qëllim rritjen e nivelit të suportit dhe zvogëlimin në kosto të mirëmbajtjeve.
- Nuk rezulton e dokumentuar ndarja e detyrave nga nivel drejtorie deri në nivel specialisti, në mënyrë që përmbushja e detyrave dhe përgjegjësia mbi punën e kryer të kenë tregues të matshëm.

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të merren masa për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit, ku të përfshihen operacionet TI, afatet dhe burimet e nevojshme, kontrollet e brendshme, menaxhimi dhe miratimi i ndryshimeve, kryerja e analizave periodike lidhur me performancën e sistemit, përshkrimet e sakta të punës dhe trajnimet periodike për gjithë punonjësit klasifikuar sipas profilit dhe përgjegjësi përkatëse.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i veprimeve operacionale mbi korrigjimet materiale që DPGJC kryen lidhur me të dhëna jo të sakta të regjistruara për shtetasit, konstatojmë se:



- Kërkesat e shtetasve për korrigjime materiale vijnë si rezultat i hedhjes gabim të dhënave në regjistrin elektronik të gjendjes civile, në periudhën kur ka filluar dixhitalizimi për popullimin e regjistrit elektronik në vitin 2010.

- DPGJC nuk disponon regjistër, me detajet e nevojshme mbi vendimet e marra (edhe pse ka një numër të konsiderueshëm vendimesh vetëm për vitin 2017 janë 3,700 vendime për korrigjime materiale), gjë që ka penguar vetë institucionin në analizimin dhe zgjidhjen e rasteve të ngjashme.

- Nga auditimi i praktikës së ndjekur për korrigjimin material, konstatohet se duhet një kohë e gjatë, që kërkesa të pasqyrohet në sistem, pasi shërbimi postar dhe ditët e nevojshme për marrjen e një vendimi i cili nuk mund të jetë negativ në momentin që ka një dokumentacion justifikues, kërkon të paktën 20 ditë pune nga momenti i kërkesës deri në pasqyrimin e ndryshimit në sistem.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile si institucion qendror që menaxhon të dhënat personale, të veprorë për hartimin dhe miratimin e veprimeve unifikuese, rregulloreve, standardeve, në monitorimin dhe përmirësimin e sistemeve, materialeve trajnuar dhe udhëzues për punonjësit dhe zyrtarë të gjendjes civile si dhe shtetasit Shqiptarë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi Nga auditimi mbi gjenerimin e certifikatave nëpërmjet portalit e-albania rezultoi se mungon dokumentimi dhe udhëzimi lidhur me çfarë hapash do të ndjekin institucionet apo qytetarët Shqiptarë, që marrin të dhënat online kur portali e-albania, për shkaqe të njohura ose të panjohura nuk funksionon, ndërkohë që punonjësit e zyrës së gjendjes civile janë urdhëruar me urdhrin nr. 933, datë 27.09.2017 “Për marrjen e masave për zbatimin e rregullave për përfitimin e certifikatave nëpërmjet shërbimit publik elektronik”, në të cilin kërkohet që zyrat e gjendjes civile të mos lëshojnë më certifikata personale dhe familjare për shtetasit, por ti informojnë ata mbi ofrimin e këtij shërbimi nëpërmjet portalit e-albania.

Gjithashtu, nga verifikime të certifikatës personale/familjare të gjeneruar nga e-albania u konstatuan mospërputhje lidhur me “Gjendja civile” dhe “Lidhja me Kryefamiljarin”, në kundërshtim me nenin 13, të ligjit nr.134/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, në të cilin specifikohet emërtimi mbi gjendjen civile.

3.1 Rekomandimi:


a. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në plotësim të urdhrit nr. 933, datë 27.09.2017 “Për marrjen e masave për zbatimin e rregullave për përfitimin e certifikatave nëpërmjet shërbimit publik elektronik”, të marrë masat, duke udhëzuar punonjësit dhe shtetasit lidhur me veprimet që duhet të ndiqen kur sistemet (Portali, Regjistri apo çdo sistem i ndërmjetëm) nuk janë në funksion për arsye të ndryshme.

a. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masat e nevojshme për unifikimin e fushave që gjenden në dy dokumentat personal që gjenerohen nga portali e-albania.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i identifikimit, dokumentimit dhe menaxhimit të incidenteve dhe problemeve në DPGJC u konstatua se nuk janë hartuar rregulla mbi menaxhimin e incidenteve, problemeve dhe institucioni nuk ka të dokumentuar një plan masash për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Në mungesë të këtyre procedurave të shkruara, problemet dhe incidentet për periudhën nën auditim, menaxhoheshin mbi bazë ngjarjesh dhe nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet email-eve.

Si hallkë monitoruese, nuk ekzistojnë procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet ose incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre për të verifikuar efektivitetin e punës së kryer. Në këtë mënyrë, institucioni nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe



18

1334

nuk ka të dokumentuar një plan masash për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT.

4.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese dhe zbatuese në DPGJC të marrin masa për hartimin e një plani veprimi për identifikimin, raportimin, trajtimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve. Gjithashtu të merren masa për menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve.

Institucioni të identifikojë risqet me efekt negativ në IT dhe veprimet që duhet të ndiqen si reagim ndaj kërcënimeve.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi Nga auditimi se si DPGJC identifikon dhe menaxhon risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se DPGJC nuk disponon një regjistër risku për teknologjinë e informacionit në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Nga strukturat drejtuese të Drejtorisë nuk është iniciuar asnjë proces për identifikimin e risqeve të lidhura me projektet e investuara, ku krahas tyre përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për menaxhimin e tyre, aktivitetet/funksionet e DPGJC të ofruara nëpërmjet aplikacioneve.

DPGJC nuk disponon asnjë mekanizëm për vlerësimin e proceseve të kompjuterizuara dhe sigurisë së të dhënave në funksion të ofrimit të shërbimeve dhe vazhdimësisë së aktivitetit, si elementë shumë të rëndësishëm të analizës së riskut.

5.1 Rekomandimi: DPGJC të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe dokumentimin e një plan-veprimi për identifikimin, raportimin, trajtimin dhe dokumentimin e risqeve, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, për shmangien, adresimin, transferimin apo pranimin e risqeve të identifikuar, si dhe monitorimin periodik për zbatimin e masave të marra nga sektori përgjegjës.


Brenda vitit 2019 dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se DPGJC, si institucion përgjegjës për të dhënat e Regjistrat Kombëtar të Shtetasve Shqiptar, nuk rezulton të ketë asnjë kërkesë apo marrëveshje dypalëshe të dokumentuar me institucionin/organin përkatës, për aksesin në të dhënat personale në kundërshtim me përmbledhësen e miratuar nga MB me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, aneksi 1 i udhëzimit nr. 95, datë 07.04.2014 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” dhe nenin 3 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar.

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të DPGJC në bashkëpunim me MB dhe Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të marrin masa për përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të Aneksit 1 të Udhëzimit nr. 95, datë 07.04.2014 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”.

a. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme i Gjendjes Civile, në vazhdimësi të autorizojë aksesin mbi të dhënat në përputhje me përmbledhësen e përditësuar dhe miratuar prej tij dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 95, datë 07.04.2014 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

 19 133

7. Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se DPGJC nuk ka të ndërtuar një strategji të rimëkëmbjes nga katastrofat si dhe nuk ka plane të shkruara që përcaktojnë vazhdimësinë e proceseve të punës. Mungesa e Strategjisë së Teknologjisë së Informacionit ka sjellë mos pasqyrimin qartë të objektivave të DPGJC lidhur me infrastrukturën TI dhe burimet e nevojshme për ngritjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen.

DPGJC, nuk rezulton të ketë dokumentim/implementim të politikave mbi sigurinë e informacionit duke patur parasysh disa elementë si:

- Përkufizim dhe kategorizim të sigurisë së informacionit me objektivat, qëllimin, konfidencialitetin e të dhënave, parimet dhe standardet, të përcaktuara në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar.
- Përkufizim të përgjegjësisë të përgjithshme dhe specifike për të gjitha aspektet e sigurisë së informacionit;
- Të përdorimit të aseteve të informacionit dhe aksesit në informacion;
- Procedurat e backup-it, trajnimit dhe edukimit mbi sigurinë;
- Planet e vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe rimëkëmbjes nga katastrofat (DRC);
- Dokumentim të ndikimit nga ndërprerjet në lidhje me: kohën, burimet dhe sistemet e tjera të lidhura me sistemin e RKGJC;
- Planet e sigurisë.

7.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në DPGJC, duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme të marrin masa për:

- a. Hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektiva e Drejtorisë;
- b. Ndërtimin dhe hartimin e Planeve të Vazhdimësisë së Biznesit duke përfshirë planet për backup dhe rimëkëmbjen nga katastrofat për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, hartimin e planit të sigurisë së informacionit dhe implementimin e tij duke përfshirë ndarjen e detyrave/përgjegjësisë të sigurisë në IT. Planifikimi dhe testimi i sistemeve IT të kryhet në përputhje me kërkesat për të cilat këto sisteme ndërtohen.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i gjurmëve të komunikimit me zyrat e gjendjes civile u konstatua se:

- Nuk ka një procedurë standarde se si veprohet për komunikimin epërdoruesve të sistemit RGJJC me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile në lidhje me problematikat e ndryshme që hasen gjatë punës. Gjithashtu këto komunikime, si dhe zgjidhjet e problemeve nuk ruhen, duke humbur kështu eksperiencë për zgjidhjen e problemeve të njëjta.
- Nga ana e DPGJC-së nuk disponohet dokumentacion për kontrollin e konfigurimeve dhe rregullimet e aplikacioneve IT. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua:
- Nuk ka një rregullore apo përcaktim të saktë për sa i përket llojit të profileve për përdoruesit. Rastet vlerësohen në vazhdimësi dhe në bazë të situatës, konfirmuar dhe nga Drejtori i Gjendjes Civile. Kjo mënyrë e përcaktimit rast pas rasti të profilit të përdoruesit nuk jep garanci të arsyeshme, për mirëfunksionimin e hierarkisë së përdoruesve në sistemin e RKGJC-së.

9.1 Rekomandimi:

- a. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të merren masa për hartimin e një procedure standarde për mënyrën e komunikimit me zyrat e Gjendjes Civile, si dhe të ruhen e të dokumentohen zgjidhjet për problemet e hasura, kontrollet e konfigurimeve dhe rregullimet e aplikacionit, veprim i cili do të mundësojë krijimin e një arkive me eksperiencat e mëparshme.
- b. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të merren masa për standardizimin e llojit të profilit të user-ave, veprim i cili ndihmon në uljen e riskut të dhënies së gabuar të aksesit për përdoruesit si dhe garantimin e mirëfunksionimit të hierarkisë së përdoruesve në sistemin e RKGJC-së.

20

1336

10. Gjetje nga auditimi Nga auditimi u konstatua se nuk ka politika apo procedura për zbulimin dhe trajtimin e ndërhyrjeve, si dhe nuk ka kontrole rutinë periodike. Në rast sinjalizimi, verifikohen loget nga Sektori i Zhvillimit në DPGJC në bashkëpunim me operatorin ekonomik mirëmbajtës së sistemit. Në lidhje me këtë, edhe pse ekziston një sektor kontrolli të procedurave i cili verifikon procedurat fizike dhe ato elektronike, niveli i trajtimit të ndërhyrjeve konsiderohet i pamjaftueshëm duke marrë në konsideratë rëndësinë kombëtare të sistemit dhe të dhënave që DPGJC administron.

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të merren masa për hartimin e një procedure dhe caktimin e personave përgjegjës për zbulimin, trajtimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të ndërhyrjeve. Sistemi i RKGJC-së është një sistem me rëndësi kombëtare si dhe konsiderohet si sistem me të dhëna sensitive për shoqërinë, e për pasojë kontrollet periodike janë të detyrueshme për ruajtjen e sistemit dhe të dhënave që mban.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi DPGJC nuk ka caktuar Administrator sistemi për asnjërin prej tyre, veprim i cili rrezikon menaxhimin dhe vazhdimësinë e punës, kryesisht në rastet kur nuk ka mirëmbajtje nga kompanitë e specializuara të kontraktuara si dhe nuk ka një pikë reference në lidhje me trajtimin e problemeve të ndryshme që dalin gjatë punës.

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të merren masa për emërimin apo kalimin e një punonjësi me detyrë Administrator i sistemit, duke shërbyer si pikë reference në lidhje me trajtimin e problemeve të ndryshme të dala gjatë punës, si dhe të mundësojë vazhdimësinë e sistemit në rastet e përkohshme kur të jemi në kushtet e mungesës së mirëmbajtjes së sistemit nga kompanitë e specializuara.


Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i të dhënave të sistemit të RKGJC me 4,537,448 rekorde të sistemit “Regjistrit kombëtar të gjendjes civile” me teknikat CAAT rezultoi:

- Ekzistojnë 30,249 fusha të paplotësuara për “adresën”, 8 fusha të paplotësuara për “ID familjare”, 28,858 fusha të paplotësuara për “lidhja me kryefamiljarin”;
- Ekzistojnë 588 rekorde të përsëritura
- U konstatuan rekorde jashtë logjikës; 5,555 raste kombësia e të cilave është shënuar XXX, XXA apo XXZ; Fusha “radha në familje” në 2,787 raste ka vlerë “0”, dhe në mjaft raste ka numra që nuk përputhen minimalisht me numrin e anëtarëve në familje; u konstatuan 6 emra me përbërje “Xxx”, nga të cilët 1 prej tyre ka edhe mbiemrin “Xxx”, dhe 1 rast ka edhe emrin e të atit “Xxx”.
- Numri i personave me moshë mbi 100 vjeç rezultoi 8,674, nga të cilët 485 janë të bllokuar dhe nuk marrin shërbim, ndërsa 8,189 persona rezultojnë nga sistemi si marrës të shërbimit (mosha e personave të filtruar arrin deri në afërsisht 150 vjeç). Referuar të dhënave nga ISSH, janë në kushtet e përfitimit të pensionit rreth 603 persona. Bazuar në komunikimet verbale me përfaqësues të DPGJC, personat mbi 100 vjeç u hiqet e drejta për të votuar deri në momentin që vetëdeklarohen. Ky veprim është konsideruar diskriminues edhe nga raporte periodike të OSBE-ODIHR, për arsye se çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë ka të drejtën e votës.
- Në sistemin e DPGJC, mungojnë parametrizime të fushave të detyrueshme “mandatory fields”, çfarë ndikon në numrin e konsiderueshëm të fushave të paplotësuara si dhe mangësi në “logical conditions”, duke pranuar të dhëna shpesh herë jashtë logjikës së përdorimit të sistemit.
- Kontrollet e inputit të të dhënave nga sistemi nuk japin siguri të arsyeshme për marrjen e të dhënave 100% të sakta.

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile:

a. Të analizohen rastet e konstatuara, duke dhënë zgjidhje të cilat të shërbejnë jo vetëm për rregullimet momentale të problematikave por gjithashtu për krijimin e një kontrolli paraprak të këtyre inputeve edhe në vazhdimësi.

 21 1337

b. Të merren masa që në bashkëpunim me institucionet vendore dhe të tjera sipas nevojës, të kryejnë verifikimet e nevojshme për shtetasit mbi 100 vjec duke mos i ndërprerë automatikisht të drejtën e votimit në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe të drejtave të barabarta para ligjit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i procedurës së mirëmbajtjes, kontratë shërbimi nr. 64/7 datë 31.12.2014 “Mirëmbajtja dhe Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të RKGJC” u konstatua se nga ana e kontraktuesit janë zhvilluar 3 module të reja (Importimin e dokumenteve të letërnjoftimit në sistemin e RKGJC, Reflektimin e adresave nga sistemi i ndërfaqes RKA, Shërbimet Ëeb me palët e treta) me kërkesë të bazuar në kushtet e kontratës, të cilat rezultuan se nuk janë kaluar në LIVE, në kundërshtim me pikën 7.9.4 të MNSH-së “Zhvillime të mëtejshme, ndërfaqe të reja për aplikacione të tjera, funksionalitete të reja”.

17.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në kuadër të respektimit të marrëdhënieve kontraktuale me ofruesin e shërbimit të mirëmbajtjes duhet të marrë masa për kalimin në Live të funksionaliteteve të kërkuara që kanë mbetur në mjedisin test, për mos u përballur me kosto shtesë për të njëjtën nevojë në zhvillim me ofruesin e shërbimeve në vijim.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi Nga Auditimi për sistemet “Ndërtimi i një sistemi funksional online të adresave dhe përditësimi i të dhënave të tij” - RKA dhe “Ndërtimi i ndërfaqes së komunikimit ndërmjet RKGJC dhe RKA” – Ndërfaqja rezultoi se:

– Dy sistemet e mësipërme RKA dhe Ndërfaqja që janë në mirëmbajtje nuk janë në “LIVE”, sepse nuk ka përfunduar popullimi plotësisht me të dhëna mbi adresat në përmbushje të qëllimit për të cilin janë ndërtuar.

– DPGJC nuk ka bërë përpjekje për rinegociim të afatit të mirëmbajtjes (marrëveshje mirëkuptimi), deri në popullimin e plotë të informacionit këto pa të cilat këto sisteme nuk kanë kuptim ku përgjegjësia i takon OSHEE si institucion qendror blerës i ngarkuar me anë të VKM nr. 207, datë 16.03.2016.

– Në marrëveshjen institucionale ndërmjet OSHEE dhe MPB nuk është përcaktuar një afat përfundimtar në lidhje me dorëzimin e të dhënave nga ana e OSHEE si institucion i ngarkuar për popullimin, ndërkohë që kontrata e OSHEE me OE për popullimin ka përfunduar.

19.1 Rekomandimi:

a. Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile si institucion i ngarkuar me ligj për administrimin e adresave të shtetasve Shqiptarë, në bashkëpunim me OSHEE të analizojë shkaqet që kanë shkaktuar vonesën në popullimin e të dhënave duke nxjerrë edhe përgjegjësitë.

a. DPGJC të marrë masat për kalimin sa më shpejt të sistemit të adresave në LIVE, nga i cili varet dhe sistemi i ndërfaqes së komunikimit, me qëllim realizimin e objektivit për secilën prej kontratave.


Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi Nga auditimi mbi vazhdimësinë e Dixhitalizimit të regjistrave dhe akteve u konstatua se:

– Fotografimi nuk vazhdon të kryhet dhe transkriptimi nga regjistrat në programin e arkivës realizohet sa herë që ka një kërkesë (rast pas rasti).

– Të dhënat, për periudhën 1974-2010 plotësohen manualisht nga punonjësi i zyrës së gjendjes civile sipas kërkesës së çdo shtetasi, për efekt gjenerimi certifikate, por ruajtja e të dhënave nuk bëhet në sistem, për arsye se sistemi aktual i RKGJC nuk është zhvilluar për ruajtjen e rekordeve me të dhëna të mëparshme që i përkasin kësaj periudhe.

20.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të marrë masat e nevojshme për vazhdimin e dixhitalizimit të arkivave duke trajtuar me përparësi fotografimin

 22

e regjistrave dhe akteve. Transkriptimi të kryhet me punonjësit e zyrave të gjendjes civile dhe ata të arkivës, në mënyrë që gabimi material të jetë sa më i vogël.

Në vijimësi

V. BASHKIA ELBASAN

KLSH në përfundim të Auditimit, për përmirësimin e gjendjes ka lënë *17 rekomandime si masa organizative*, me shkresën nr.864/5, datë 17.12.2018 sipas Vendimit nr.197, datë 14.12.18 të Kryetarit të KLSH-së, është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr.864/1, datë 11.09.2018.

Bashkia Elbasan me marrjen e raportit përfundimtar dhe rekomandimeve ka hartuar Urdhrin e Brendshëm nr. 1064 datë 21.12.2018 “Mbi masat për zbatimin e rekomandimeve të KLSH” dhe planin e veprimit “Për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH”, për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së përcjellë në KLSH brenda afatit ligjor me shkresën nr.5841/11 prot. datë 21.12.2018 (Bashkia Elbasan).

Bashkia Elbasan nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga 17 rekomandime, si masa organizative, janë pranuar plotësisht nga ana e subjektit të audituar, nga të cilat 3 janë zbatuar plotësisht, 1 është zbatuar pjesërisht, 10 janë në proces zbatimi dhe 2 masa organizative nuk janë zbatuar.

KLSH kërkon intensifikimin e veprimeve, për përfundimin e rekomandimeve që rezultuan në proces dhe pjesërisht të zbatuar si dhe marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga Auditimi: *Nga auditimi u konstatua se Struktura IT ka një bazë rregullative të plotësuar (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup etj...), por kjo bazë rregullative është e pa miratuar.*


1.1 Rekomandimi: *Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan të marrin masa për miratimin e bazës rregullative të Teknologjisë së Informacionit (rregullorja e strukturës IT dhe ndarja e detyrave, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, manuale të aplikacioneve të përfituara si rezultat i donacioneve, dokumentacion mbi procedurat e backup).*

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: *Nga auditimi u konstatua se nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2017-2018 për burimet njerëzore të sektorit të Teknologjisë së Informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre. Trajnimet e përfituara nga donatorët dhe zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.*

2.1 Rekomandimi: *Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve IT si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.*

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

 23 133

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Elbasan nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit, mungesa e të cilës sjell mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave. Mungesa e Planit Strategjik, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së Bashkisë Elbasan

4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

6.Gjetje nga Auditimi: Rregullorja e Brendshme, lidhur me strukturën IT në Bashkinë Elbasan, nuk është në përputhje me rekomandimet e AKSHIT, rregullorja nuk përmban elementët e nevojshëm për të siguruar funksionim e përshtatshëm të strukturës IT në institucion.

6.1 Rekomandimi: Bashkia Elbasan të hartojë, dhe miratojë Rregulloren e Brendshme, lidhur me strukturën IT. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale të sektorit si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Bashkia Elbasan nuk disponon regjistër risku për teknologjinë e informacionit në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

7.1. Gjetje nga Auditimi Bashkia Elbasan nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohet mbi bazë ngjarjesh.

Jepet suport, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit. Procedurat kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve, duke mos realizuar identifikimin e risqeve, mbart riskun e përsëritjes së incidenteve. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

7.2. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorit të Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për:

- a. identifikimin e risqeve IT dhe hartimin e regjistrit të risqeve.
- b. dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve.
- c. menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Bashkia Elbasan nuk rezulton të ketë plan të miratuar emergjence dhe politika të miratuara për vazhdimësinë e biznesit. Politika organizative mbi vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve duke marrë në konsideratë: rolet dhe përgjegjësitë, fushëveprimin, kërkesat për trajnim, orarin e mirëmbajtjes, orarin e testimit, nivelet e miratimit dhe palët e

 24 1340

përfshira në këtë proces. Nuk janë përcaktuar Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes dhe Objektivat e Punës së Ripërtëritjes për çdo proces kritik.

8.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike të marrin masa për miratimin e një plani për emergjenca dhe politika mbi vazhdimësinë e biznesit.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Siguria e infrastrukturës network në Bashkinë Elbasan është e kompromentuar si rezultat i mungesës së:

- a. Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.
- b. server të dedikuar për CA (Certificate Authority)
- c. Server i dedikuar për mail server (Exchange server)
- d. Firewall Hardware
- e. Switch të menaxhueshëm

9.1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i rrjetit kompjuterik që lidh Bashkinë Elbasan me qendrat administrative rezultoi se:

- a. Përdoruesit në këto qendra janë lidhur nga fibra optike dhe marrin shërbimin në një Switch të pa menaxhueshëm.
- b. Konfigurimet në rrjet të PC janë si administratorë.

Në të njëjtin switch marrin shërbime disa institucione

9.2. Gjetje nga Auditimi: Nuk dokumentohet procesi i hapjes dhe mbylljes së përdoruesve në sisteme.

9.3. Rekomandimi: Bashkia Elbasan për mbarëvajtjen e punës dhe për të pasur siguri në rrjet duhet të marri masat për t'u pajisur me: Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet.; server të dedikuar për CA; Server i dedikuar për mail server, Firewall Hardware, Switch të menaxhueshëm.

Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:


a. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

b. Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

 25 1341

10.1 Gjetje nga Auditimi: Mungon Siguria e Hyrjes në dhomë. Duhet të jetë e siguruar me anë të një sistemi elektronik dhe natyrisht duhet të ketë dhe sistem alarmi në rast thyerje.

10.2 Rekomandimi: Bashkia Elbasan të marr masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i Kontratës nr.2474 “Shërbim Interneti për Bashkinë Elbasan dhe Njësitë e vartësisë” rezultoi se grupi i marrjes në dorëzim grupi i marrjes në dorëzim nuk ka një raport të marrjen në dorëzim të punimeve të kryera (në këtë rast shërbimin e Internetit) nga OE në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Neni 77, Pika 3. *Mbikëqyrja e kontratës.*

Në disa nga faturat Tatimore, të sjella nga Operatori Ekonomik Albtelecom SH.A., Blerësi në këtë rast Autoriteti Kontraktor (Bashkia Elbasan), ka firmosur këto fatura vetëm me emrin “Bashkia Elbasan” dhe jo grupi i marrjes në dorëzim të shërbimit të internetit.

Përkatësisht në faturat nr. 90726620, nr. 90735561.

Ndërsa faturat e tjera janë firmosur vetëm nga një përfaqësues i grupit të marrjes në dorëzim.

4 MNSH

U kontrolluan këto Kontrata për MNSH (Marrëveshje Nivel Shërbimi):


- Nr. Kontrate 8796 “Elbasan Virtual Tour 360”
- Nr. Kontrate 9756 “Projekti i monitorimit të ambientit në qytetin e Elbasanit”
- Nr. Kontrate 472 “Mirëmbajtje e platformës: Transport Inteligent”

12.1 Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i këtyre procedurave rezultoi se të gjitha marrëveshjet e nivel shërbimit (MNSH), që janë me afat 4 vjeçar, grupi i marrjes në dorëzim nuk ka një raport të marrjen në dorëzim të punimeve të kryera nga OE në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Neni 77, Pika 3. *Mbikëqyrja e kontratës Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkëlqes së kushteve të kërkuara zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi” Procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i komisionit që merr në dorëzim.*

12.2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i Kontratës Nr. 8796 “Elbasan Virtual Tour 360” rezultoi se, kjo kontratë nuk ka MNSH (Marrëveshje Nivel Shërbimi) në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për Hartimin E Marrëveshjes Së Nivelit Të Shërbimit i cili citon: “Institucionet, të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e TIK-ut, detyrimisht, të parashikojnë MNSH-në, si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këto sisteme. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.” c)U konstatua se në të gjitha MNSH nuk përfshihen: *koha e raportimit; koha e përgjigjes; prioriteti; përshkallëzimi*

Kjo në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për Hartimin E Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit e cila citon:

Të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të shërbimit Ky seksion duhet të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet që ofruesi i shërbimit ka ndaj institucionit, në lidhje me ofrimin e shërbimit. Për sa u përket detyrimeve, duhet të përcaktohen metodologjitë dhe specifikat e suportit të ofruesit të shërbimit të MNSH-së; për sa i përket ndërmarrjes së të gjitha veprimeve në kohën e duhur.

 26 1342

Në lidhje me shërbimet që do të përcaktohen në marrëveshje, ofruesi i shërbimeve duhet t'u përgjigjet dhe të zgjidhë kërkesat ose incidentet e paraqitura nga institucioni. Gjithashtu, ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë dokumentacionin e plotë për komponentët e shërbimit; të garantojë personel të kualifikuar dhe në numër të mjaftueshëm për realizimin e shërbimit; të ofrojë sigurimin e pjesëve të këmbimit (kur është e aplikueshme) dhe në sasinë që do të duhen për t'u ndërruar brenda harqeve kohore të përcaktuara.

12.3 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në të ardhmen për të shmangur mangësi në praktikat e zbatimit të kontratave duhet të marr masa për zbatimin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Siguria e aplikacioneve si rezultat i mos dokumentimit të procesit të hapjes dhe mbylljes së kredencialeve të përdoruesve në aplikacionet është e kompromentuar.

13.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike duhet të marrin masa për dokumentimin e procesit të hapjes dhe mbylljes së kredencialeve të përdoruesve në aplikacione.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Bashkia Elbasan nuk ka infrastrukturën e nevojshme për të siguruar aplikacionet e zhvilluara, ambienti fizik komprometon sigurinë e aplikacioneve. Bashkia Elbasan nuk ka ambient të veçantë për testime përpara kalimit të ndryshimeve në sistemin Live për aplikacionet mungesa e të cilit komprometon sigurinë e sistemit, të dhënave si dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve.

14.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike, të marrë masa për një riorganizim të hapësirave fizike dhe logjike në pajisjet server lidhur me shërbimet që ofron aktualisht, me qëllim:

- Garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve të ofruara.
- Përfitim të një performace më të mirë të aplikacioneve.
- Krijim hapësire për një kopje të sistemit në funksion të testimeve apo trajnimeve të ndryshme sipas rastit.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

15. Gjetje nga Auditimi: Sistemi i Administrimit të Taksave (TAIS) nuk ndërvepron me sistemin QKB për të marrë automatikisht të dhënat e bizneseve me impakt mos informimin në kohë për bizneset e reja të regjistruara.


15.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan, në bashkëpunim me Sektorin IT dhe Drejtorinë e Taksave Vendore të marrë masa për hartimin e një plan veprimi për të siguruar ndërveprimin e bazës së të dhënave të QKB me atë TAIS.

Brenda Vitit 2019 dhe në vijimësi

16. Gjetje nga Auditimi: Sistemi i Administrimit të Taksave (TAIS) nuk disponon sisteme kontrolli për parandalimin e inputeve të pa sakta në bazën e të dhënave, duke lejuar parregullsi në fushat e rëndësishme të bazës së të dhënave si "NIPT", "Adresa" "Emërtimi i Biznesit"

16.1 Rekomandimi: Sektori i Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore si dhe zhvilluesin e sistemit TAIS, të marrë masa për të përcaktuar kriteret e nevojshme dhe detyrueshme të formatit për çdo fushë të bazës së të dhënave në TAIS si dhe të vendosi sisteme kontrolli për parandalimin e inputeve të gabuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

 27 134

17. Gjetje nga Auditimi: Siguria e vazhdimësisë së punës së aplikacioneve është e cenuar nga:

a. Mungesa e testeve të Back-up dhe Resotre

b. Mos përcaktimin në rregullore të frekuencës së kryerjes së Back-up dhe testimit të tij

c. Mos përcaktimi i afatit të ruajtjes së informacionit në Backup

d. Ruajtjes të Back-up në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (dhoma e serverave).

17.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Elbasan në bashkëpunim me Sektorin e Inovacionit IT dhe mbrojtjes Kibernetike, të marrë masa për përcaktimin e kryerjes së testeve të Back-Up dhe Retore, frekuencën e kryerjes së këtyre testeve, afatin e ruajtjes së informacionit në Back-Up si dhe ruajtja e Back Up në një ambient të ndryshëm nga ai i dhomës së serverave.

Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi

VI. QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT - QKB

KLSH në përfundim të Auditimit, për përmirësimin e gjendjes ka lënë 22 rekomandime si masa organizative dhe 1 propozim apo përmirësim në legjislacion, me shkresën nr.550/8, datë 17.09.2018 sipas Vendimit nr.129, datë 13.09.2018 të Kryetarit të KLSH-së, është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. 550/2, datë 30.05.2018.

Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatim e rekomandimeve të KLSH ka hartuar brenda afatit (21.09.2018) planin e veprimit por nuk ka vënë në dijeni për këtë veprim KLSH-në brenda afatit 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

QKB me shkresën e saj nr.4109 datë 15.03.2019, protokolluar në KLSH me shkresën nr.550/14 datë 21.03.2019 ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga 22 rekomandime, si masa organizative, janë pranuar plotësisht nga ana e subjektit të audituar, nga të cilat janë zbatuar 9 masa dhe janë në proces zbatimi 11 masa organizative, ndërkohë që 2 masa organizative nuk janë zbatuar. Nga 1 masë propozim apo përmirësim në legjislacionit, 1 masë është në proces zbatimi.


KLSH kërkon intensifikimin e veprimeve, për përfundimin e rekomandimeve që rezultuan në proces si dhe marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, si vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACION

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi lidhur me të dhënat për pasqyrat financiare të subjekteve dhe raportet e auditit/veprimtarisë është konstatuar se:

1. Këto të dhëna janë parësore në regjistrin e biznesit në QKR, në përputhje me nenin 43, germa a, të ligjit nr. 9723, datë "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i përditësuar, si dhe VKM nr. 863, datë 21.10.2015 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, regjistritregtar". Afati përfundimtar për depozitimin e tyre, sipas nenit 43, germa a, është data 31 Korrik e çdo viti, në të kundërt ndaj subjektit vendoset gjoba prej 15,000 lekë bazuar në nenin 74, pika 3.

 28 1344

2. Pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit/veprimtarisë janë të detyrueshme për t'u plotësuar edhe në sistemin tatimor të DPT sipas nenit 29 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. DPT ushtron kontroll mbi elementët e pasqyrave financiare, lejon ose jo ndryshimin e tyre dhe i certifikon ato.

3. Pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit/veprimtarisë përmbajnë të dhëna që sipas nenit 25 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, i nënshtrohen kushteve të konfidencialitetit, ndërkohë që po të njëjtat të dhëna të subjekteve në QKB kërkohen të dorëzohen brenda afateve të përcaktuara me ligj e me gjoba në rast mos përmbushje në shërbim të transparencës.

4. Bazat ligjore të dy institucioneve i kërkojnë biznesit të njëjtën të dhënë të klasifikuar si parësore, të paraqitet në dy sisteme të ndryshme, tek ai i regjistrit të biznesit në QKB si dhe ai tatimor në DPT, çfarë bie ndesh me nenin 7 të ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore".

5. QKB dhe DPT janë dakordësuar me marrëveshjen nr. 1242/1, datë 07.09.2017, pa marrë parasysh faktin që transparenca mbi të dhënat e subjekteve në QKB e zhbën konfidencialitetin për të njëjtat subjekte në DPT.

6. Subjektet dorëzimin e pasqyrave financiare e kryejnë në dy institucionet (QKB/DPT), ku që prej vitit 2015 për llogari të QKB, e kryen nëpërmjet portalit e-albania (para këtij viti këto veprime kryheshin në sportel), ndërsa për llogari të DPT në sistemin tatimor i cili është dhe përgjegjës për vënien në dijeni të QKB për subjektet që kanë këtë detyrim.

1.1. Rekomandimi: Ministria e Financave në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të shqyrtojë mbivendosjet e mësipërme ligjore, përse i përket deklaratimit të pasqyrave financiare, e cila rezulton si e dhënë parësore në dy institucione (QKB/DPT), si rezultat i kërkesave ligjore respektive: ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit" i përditësuar dhe ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, gjë e cila vjen në kundërshtim edhe me ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore", konkretisht me:

nenin 4 "Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore", pika 3, ku cilësohet:

"Ndalohej krijimi i bazave të të dhënave shtetërore të veçanta për të njëjtin informacion ose qëllim".

nenin 7 "Të dhënat parësore dhe dytësore" ku cilësohet:

"Baza e të dhënave shtetërore përmban të dhënat parësore dhe të dhënat dytësore.

a) Të dhënat parësore të një baze të dhënash shtetërore janë informacione specifike, të mbledhura nga institucioni administrues, në përputhje me aktin e krijimit.

b) Të dhënat dytësore janë të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore"

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me Planin Strategjik të Teknologjisë së Informacionit rezulton se, Qendra Kombëtare e Biznesit nuk ka të ndërtuar një Plan Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, çfarë sjell mos pasqyrimin të qartë të objektivave të QKB, lidhur me sigurinë institucionale dhe infrastrukturën TIK, objektivat strategjike për burimet njerëzore të strukturës së TIK në QKB, si dhe në degët rajonale në lidhje me burimet e nevojshme për ngritjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

1.1. Rekomandimi: QKB në bashkëpunim me Drejtorinë e Inovacionit dhe Regjistrave si dhe me strukturat këshilluese mbi TIK, të marrë masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit, duke marrë në

konsideratë kohën, burimet e nevojshme dhe rishikimin vjetor të indikatorëve të performancës së ecurisë së objektivave.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me Planin e Rimëkëmbjes nga Katastrofat, QKB si institucion që administron të dhëna me rëndësi për regjistrimin dhe licencimin në dy sisteme informacioni (QKR dhe QKL), përcaktuar në ligjin organik që rregullon regjistrimin dhe licencimin e biznesit, rezulton se nuk ka qendër të rimëkëmbjes nga katastrofat (DRC) për serverat e sistemeve QKR dhe QKL të cilët hostohen tek data centeri i AKSHI-t, si dhe nuk ka të hartuar një plan të politikave të vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) dhe dokumentim mbi planin e rimëkëmbjes nga katastrofa (DRC).

2.1. Rekomandimi: QKB, duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme të marrë masa për ndërtimin dhe hartimin e Planeve të Vazhdimësisë së Institucionit, duke përfshirë planet për backup dhe rimëkëmbjen nga katastrofat për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, hartimin e planit të sigurisë së informacionit dhe implementimin e tij, duke përfshirë ndarjen e detyrave/përgjegjësisë të sigurisë në TIK. Planifikimi dhe testimi i sistemeve TIK të kryhet në përputhje me kërkesat për të cilat këto sisteme ndërtohen.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbidokumentimin e regjistrat elektronik të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve si bazë të dhënash shtetërore rezulton se, ky regjistër është i pa miratuar me akte ligjore.

3.1. Rekomandimi: AKSHI të marrë masa për nxjerrjen e akteve ligjore për miratimin e Regjistrat elektronik të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve si autoritet rregullator koordinues, përgjegjës për përpunimin, përditësimin dhe standardizimin e procedurave dhe rregullave për krijimin, regjistrimin, përfundimin e funksionimit, administrimin, ndërveprimin dhe sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore dhe elementëve të tjerë specifikë që lidhen me këto procese.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e Teknologjisë së Informacionit është e pa miratuar, ndërkohë që Drejtoria e Inovacionit dhe Regjistrave e ka mbështetur aktivitetin e saj në këtë rregullore. Me miratimin dhe futjen në fuqi të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, rregulloret e miratuara nga QKB nuk janë efikase dhe efektive për t’u përdorur dhe do të duhet t’u nënshtrohen një rishikimi të hollësishëm, duke reflektuar ndryshimet që do të ndodhin në strukturë, në përshkrimet e punës dhe në ndarjen e përgjegjësisë të gjithsecilit, për t’u përshtatur me kërkesat e kësaj VKM-je. Drejtoria e Inovacionit dhe Regjistrave në QKB është një nga strukturat që preket nga miratimi dhe futja në fuqi e VKM-s nr. 673 ku sipas së cilës, stafi TI dhe pajisjet kalojnë në varësi të ASKHI-it.

4.1. Rekomandimi: QKB të marrë masa për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit në QKB, në të cilën të identifikohen të gjitha operacionet TIK në institucion, afatet dhe burimet e nevojshme për çdo veprimtari. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë të gjitha rregulloret e miratuara dhe kërkesat që vijnë si rezultat i futjes në fuqi të VKM-s 673, datë 22.11.2018 si dhe legjislacionin e Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimet operacionale rezulton se, thjeshtimi i veprimeve në sportel ka deleguar fluksin tek regjistruesit, që aktualisht duhet të kalojnë çdo veprim në miratim edhe kur risku është i ulët, ose i pa konsiderueshëm. Në ndërtimin e sistemeve QKB nuk ka marrë në konsideratë miratimin e thjeshtë (simple approve), në momentin e aplikimit për krijime, apo ndryshime të elementëve të caktuar të regjistrat që janë lehtësisht të verifikueshëm që në sportel.

6.1 Rekomandimi: QKB të analizojë nevojën për miratim të veprimeve operacionale me risk të ulët, për të gjitha llojet e sporteve përfshirë dhe shërbimin online të e-albania, për kalimin me miratim të thjeshtë në sportel, në funksion të një menaxhimi më të mirë të kërkesave nga biznesi, si dhe të burimeve njerëzore që vetë institucioni disponon.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se QKB-së, nuk i është mundur leximi i detyrimeve tatimore në kohë reale në sistemin e DPT, në kundërshtim me objektin e marrëveshjes me nr. 12420/1, datë 07.09.2017. Konkreti sht, në lidhje me leximin e të dhënave në DPT për situatën aktuale tatimore të subjekteve që aplikojnë për çregjistrim, rezulton se aplikimet për çregjistrim nga QKB dërgohen në kohë reale në DPT dhe me shkresë zyrtare në njësitë vendore. DPT dhe njësitë vendore i përgjigjen kërkesës së QKB në lidhje me detyrimet e subjektit që ka aplikuar për çregjistrim me shkresë zyrtare dhe jo nëpërmjet sistemit.

8.1. Rekomandimi: DPT, si palë në marrëveshjen e lidhur me QKB, të marrë masa që në zbatim të marrëveshjes me QKB nr. 12420/1, datë 07.09.2017, të mundësojë QKB-së, nëpërmjet ndërveprimit të të dhënave, leximin në kohë reale, të situatës aktuale tatimore.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ndërveprimit për elementë të rëndësishëm rezultoi se DPT nuk merr nga QKB të dhëna në kohë reale, por nëpërmjet postës elektronike me komunikime periodike javore për:

- Aplikimet për aktivizim;
- Fillimin e procedurave për likuidim;
- Bashkim me përthithje;
- Ndarjen e shoqërisë;
- Shndërrimin e shoqërisë.

10.1. Rekomandimi: QKB në bashkëpunim me DPT të përfshijnë në protokollin e komunikimit elektronik dhe të realizojë shkëmbimin në kohë reale ndërmjet sistemeve, të dhënat që marrin periodikisht, për një pasqyrim sa më të saktë dhe në një afat të shkurtër për:

- Aplikimet për aktivizim;
- Fillimin e procedurave për likuidim;
- Bashkim me përthithje;
- Ndarjen e shoqërisë;
- Shndërrimin e shoqërisë.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga trajtimi i incidenteve dhe gabimeve ka rezultuar se, QKB nuk ka të dokumentuar dhe implementuar një procedurë të standardizuar për kontrollin e ndryshimeve në infrastrukturë dhe në sistemet e TIK në institucion. Situata në QKB dhe në degët rajonale, për periudhën nën auditim, menaxhohet mbi baza ngjarjesh. Gjithashtu, nuk disponohet procedurë për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiave për kryerjen e ndryshimeve (update, upgrade, etj.), struktura kontrolli për verifikimin e efektivitetit të ndryshimeve të kryera, procedura për ndryshimet emergjente si dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve, duke përfshirë dhe incidentet që vijnë nga ndërveprimi i të dhënave.

Nga auditimi rezulton se mungon formati kur çështja hapet nga vetë punonjësit në zbatim të urdhrave apo vendimeve të ndryshme që janë detyruese për zbatim.

11.1. Rekomandimi: QKB të marrë masa organizative lidhur me hartimin dhe vënien në funksion të rregullores për trajtimin e incidenteve dhe gabime, masave shtesë, personat përgjegjës si dhe afatet për ngjarje të të pa parishikuara, të cilat mund të ndodhin gjatë punës me veprime operacionale. Në rregullore të përfshihen dhe veprimet, që vijnë si rezultat i

vendimeve të ndryshme detyruese për ekzekutim, si dhe ndryshimet që ndodhin brenda për brenda TIK.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i menaxhimit të shërbimeve TIK dhe dhënies së suportit, ka rezultuar se, në mungesë të strukturës/sektorit Help Desk në QKB, nuk sigurohet menaxhimi i shërbimeve TIK dhe plotësimi i kërkesave të përdoruesve të institucionit si dhe degëve rajonale. Duke parë rëndësinë e QKB-së, në dhënien e shërbimeve për biznesin, duhej të gjendej mënyra për dhënie sporti, ku të përcaktoheshin detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit për të garantuar dhe siguruar cilësinë e shërbimeve ndaj biznesit dhe qytetarëve.

14.1. Rekomandimi: QKB, duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme, të marrë masa për dhënien e suportit, për plotësimin e kërkesave të përdoruesve të institucionit dhe degëve rajonale për të siguruar cilësinë e shërbimeve ndaj biznesit dhe qytetarëve.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Mungesa e trajnimeve dhe planifikimi i trajnimeve. Nga auditimi i burimeve njerëzore në strukturën e TIK dhe menaxhimi i kapaciteteve të personelit që ka akses në asetet e informacionit të QKB në mënyrë që të jetë i vetëdijshëm për rregullat dhe standardet e sigurisë dhe të jenë të aftë t'i zbatojnë dhe ndjekin ato gjatë punës së tyre u konstatua se:

- Drejtoria e Inovacionit dhe Regjistrave ka mungesa në personel;
- QKB dhe Drejtoria e Inovacionit dhe Regjistrave nuk ka një analizë të nevojave për trajnim të stafit të drejtorisë dhe nuk ka plan për trajnime. Stafi i Drejtorisë së Inovacionit dhe Regjistrave nuk ka kryer asnjë ditë trajnim për sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit, etj.

15.1. Rekomandimi: QKB të marrë masa për menaxhimin e burimeve njerëzore, duke plotësuar nevojat për trajnime të stafit të Drejtorisë së Inovacionit dhe Regjistrave, si dhe të hartojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mungesa në kapacitetet e serverëve si më poshtë:

- Serverat kanë mungesë në hapësirat fizike dhe logjike, duke ndikuar në performancën dhe mbarëvajtje e sistemeve, si dhe duke rrezikuar në humbjen e të dhënave. Transactional backup nuk bëhet për shkak të mungesës së hapësirave në serverin e databazës.
- Backup-i i sistemit të regjistrave të biznesit, realizohet në mënyrë manuale nga punonjësit e Drejtorisë së Inovacionit dhe Regjistrave.
- Disa nga volumet Hdd nuk janë të konfiguruar në redundant RAID, gjë e cila mund të sjellë humbje të dhënash në raste aksidentesh apo në raste të dështimit të një Hdd, etj.
- Serverat e sistemit QKL për shkak të mungesës së suportit nga ana e prodhuesit kanë kaluar në status "retired".
- Upgrade-imi i SQL Servers në versione më të reja nuk mund të realizohet, për arsye të mungesës së kapaciteteve të vetë serverave dhe kushteve të tjera optimale, që kërkohen për të kaluar në versione më të reja.

16.1. Rekomandimi: QKB në bashkëpunim me Drejtorinë e Inovacionit dhe Regjistrave si dhe me strukturat këshilluese mbi TIK, të marrin masa për:

- analizimin dhe dokumentimin e situatës së krijuar dhe krijimin e kushteve optimale mbi rritjen e kapaciteteve (hapësirave storage) të serverave të sistemeve për të siguruar mbarëvajtjen e sistemeve dhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje;
- kryerjen backup-it të particioneve të konsideruara kritike dhe klasifikimin e të dhënave të rëndësishme;
- kryerjen e konfigurimeve përkatëse të Hdd-ve ose volumeve që nuk janë të konfiguruar si redundant RAID.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i portalit rezultoi se, nuk përdoret një lidhje e sigurt (connection security) HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) (Not secure status) që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues, si Chrome. Në mungesë të kësaj certifikate mund të ndodhë humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali.

17.1. Rekomandimi: QKB në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e faqes web, të marrin masa për përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë (certifikatën e sigurisë) së navigimit online për të rritur sigurinë dhe ndihmesën ndaj qytetarëve. Të kihet parasysh që në të ardhmen të shtohen elementë inovativ në faqen Web për ta bërë atë sa më interaktive dhe ndihmëse për qytetarët.

Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultojnë të pa standardizuar formularët për 56 shërbime për regjistrin e biznesit, si dhe 6 shërbime për regjistrin e Licencave/Lejeve dhe Autorizimeve.

19.1. Rekomandimi: QKB të analizojë të gjitha mundësitë operationale dhe ato financiare duke renditur grupimin e formularëve nga prioriteti me i lartë, për standardizimin e formularëve që kanë numër të madh aplikimesh.

Në vijimësi

Shënim: Bashkëlidhur Aneksi Nr.1 dhe Aneksi Nr.2, për paraqitjen tabelare të zbatimit rekomandimeve për 6 subjektet e verifikuara për zbatimin e rekomandimeve.

BUJAR LESKAJ

KRYETAR



Departamenti Auditimit të Teknologjisë së Informacionit
Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve në 6 subjekte të evaduara në maj-dhjetor 2018

Aneksi nr. 1 . Masa Organizative:

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar Pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
a	b	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	AKSHI	16		16	1	7	4	4
2	APP	18		18	6	0	12	0
3	BASHKIA ELBASAN	17		17	3	1	11	2
4	DAP	10	1	9	1	0	7	1
5	DPGJC	20		20	6	0	6	8
6	QKB	22		22	9		11	2
	GJITHSEJ	103	1	102	26	8	51	17
	Në %		1%	99%	25.4%	7.8%	50%	16.6%

Aneksi nr. 2 . Propozime për përmirësime në legjislacion:

Nr	Emërtimi i Subjekteve	Reko manduar	Pa pranuar	Pranuar	Nga rekomandimet e pranuar :			
					Zbatuar	Zbatuar Pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
a	b	1	2	3 (1-2)	4	5	6	7
1	AKSHI							
2	APP	2		2				2
3	BASHKIA ELBASAN							
4	DAP							
5	DPGJC							
6	QKB	1		1			1	
	GJITHSEJ	3		3			1	2
	Në %		0%	100%	0%	0%	33.3%	66.6%

Tiranë, më 16.09.2019

